



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 53 regjistër (JR)
Datë 20.12.2024

Nr. 8 i vendimit
Datë 26.01.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 26.01.2026, ditën e hënë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 53/2024 (JR), datë 20.12.2024, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Xhemal Saliaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 805, datë 07.10.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës, nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet në parashtrimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 805, datë 07.10.2024, dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes, Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Xhemal Saliaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit Xhemal Saliaj¹, duke konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”), pas përfundimit të procedurave për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, të kryera nga grupi i punës, në raportin e përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 05.11.2017², ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Xhemal Saliaj.
5. Këshilli i lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”) ka dërguar në Komision raportin e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Xhemal Saliaj³, të bazuar në analizimin e formularit të

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 02.04.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Xhemal Saliaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”.

² Deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 04.07.2023, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”.

³ Raportin me nr. {***} prot., datë 10.07.2023, “Për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Xhemal Saliaj”.

vetëdeklarimit, tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e mësipërme, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Xhemal Saliq, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale).

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 805, datë 07.10.2024, me shumicë votash, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Xhemal Saliq, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë [...].*

8. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme:

- Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

- *Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara, në kuptim të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 e 33 të ligjit nr. 84/2016.*

- *Në rastin konkret, pamjaftueshmëria financiare, si dhe faktet lidhur me analizimin e pasurisë, e çojnë trupin gjykues në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e pasurisë sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe në vlerësimin tërësor ka cenuar besimin e publikut të drejtësia.*

- *Sipas vlerësimit të trupit gjykues, referuar kuadrin kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, rrethanat dhe konkluzionet e arritura më lart, çojnë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Xhemal Saliq, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.*

- Për kriterin e kontrollit të figurës: [...] *Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Xhemal Saliq, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

- Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: [...] *Komisioni arrin në përfundimin se faktet e referuara dhe të analizuar më sipër në këndvështrim të përgjithshëm, nuk do të ishin të mjaftueshme për të arritur në një konkluzion negativ lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, por këto fakte, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, cenonë shkallën e besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit, sipas pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

- *Në përfundim, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe, në vlerësimin tërësor, ka cenuar besimin e publikut të drejtësia në kuptim të parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit

9. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 805, datë 07.10.2024, duke e kundërshtuar atë në drejtim të procedurës së ndjekur nga ana e Komisionit, si dhe vlerësimin e kryer nga ky i fundit për kriterin e pasurisë, por edhe atë etiko-profesional.
10. Ankimi i subjektit të rivlerësimit përmban shkaqe të natyrës procedurale, si dhe shkaqe të tjera që lidhen me: (i) vlerësimin e kriterit të pasurisë; (ii) vlerësimin e dosjeve penale të analizuar nga Komisioni në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale; si dhe (iii) konkluzionin mbi cenimin e besimit të publikut. Sipas subjektit, Komisioni ka shkelur parimet e procesit të rregullt ligjor, ka bërë vlerësim të gabuar të provave të administruara dhe ka interpretuar gabim ligjin material.
11. Subjekti i rivlerësimit kërkoi që çështja të shqyrtohej në seancë gjyqësore publike me praninë e tij dhe të riçelet hetimi gjyqësor, në funksion të konstatimit të drejtë të situatës faktike. Ankuesi ka kërkuar që gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, të paraqesë dokumente mbi të ardhurat e thjeshtit të motrës dhe, duke iu referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), kërkoi pranimin e tyre si prova të reja, duke argumentuar se nuk ka mundur t’i paraqesë më parë, pa fajin e tij, pasi vetëm në vendimin përfundimtar, ka marrë dijeni që në shpenzimet jetike të motrës, janë përfshirë edhe shpenzimet për thjeshtin, fakt i cili nuk ishte evidentuar gjatë fazës së hetimit administrativ.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjyqimit

(a) Juridiksioni i Kolegjit

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin kalimtar të subjektit Xhemal Saliaj, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

(b) Legjitimimi i ankuesit

13. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

(c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes*

14. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i çështjes në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 805, datë 07.10.2024, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit Xhemal Saliaj, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
15. Subjekti i rivlerësimit, më datë 15.01.2026, paraqiti në Kolegj parashtrime me shkrim, në përputhje me parashikimet e nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, si dhe disa dokumente për të cilat kërkoi marrjen si provë e re në gjykim, në funksion të provimit të shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë⁴.
16. Lidhur me kërkesën e ankuesit për marrjen e provave të reja, trupi gjykues çmoi se vërtetimi i lëshuar nga Agjencia Kombëtare Elektronike e Sigurimeve Shoqërore dhe Pensioneve të Greqisë, datë 23.06.2025, duhet të trajtohet në kuadër të nenit 49, pika 3 e ligjit nr. 84/2016⁵. Nga përmbajtja e dokumentit, rezulton se shtetasi J. K. ka përfitur pension për shkak të vdekjes së bashkëshortes për periudhën 01.06.2003 – 01.03.2007. Përfitimi i pensionit familjar në rastin e humbjes së njërit prind nga një fëmijë i mitur në një vend të Bashkimit Europian (Greqi), është një standard dhe fakt i njohur, pasi ky pension parashikohet edhe në legjisllacionin shqiptar. Për rrjedhojë, administrimi i kësaj prove u konsiderua i panevojshëm, pasi trupi gjykues e konsideroi të prezumuar përfitimin e pensionit nga një fëmijë i mitur për shkak të vdekjes së nënës së tij. Lidhur me provat e tjera, trupi gjykues konstatoi se certifikata e gjendjes familjare të shtetasit J. K. ishte administruar edhe më parë gjatë procesit në Komision, kurse provat e tjera nuk plotësonin kriteret e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe, si rrjedhojë, nuk u pranua marrja e tyre si prova të reja në gjykim.
17. Në vijim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, në praninë e tij, si dhe kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nëpërmjet dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit, nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që do të kërkonin korigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, nëpërmjet zhvillimit të gjykimit në seancë gjyqësore publike me praninë e ankuesit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të mos pranojë kërkesën për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe të vijojë

⁴ Vërtetim i lëshuar nga Agjencia Kombëtare Elektronike e Sigurimeve Shoqërore dhe Pensioneve të Greqisë, datë 23.06.2025, që i përket shtetasit J. K., certifikatë e gjendjes familjare të J. K., si dhe deklaratë e shtetasve F. dhe V. H., lidhur me konfirmimin e çmimit të shitjes së pasurisë apartament me sipërfaqe 71,71 m², në vlerën 3.500.000 lekë, fotografi e nënës së subjektit.

⁵ Neni 49, "Mjetet për kërkimin e provës": "[...] 3. Faktet e njohura për Komisionin ose faktet e njohura botërisht, si dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme [...]".

shqyrtimin e saj në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni

18. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimi i Komisionit është marrë në kundërshtim me nenin 6/1 të KEDNj-së, nenin 42 dhe nenin 142/1 të Kushtetutës, për shkak të cenimit të parimit të sigurisë juridike, mungesës së një vendimi të arsyetuar dhe mosrespektimit të jurisprudencës së mëparshme të Komisionit dhe Kolegjit. Sipas tij, Komisioni është larguar pa dhënë arsye bindëse nga praktika e konsoliduar vendimmarrëse, lidhur me vlerësimin e dokumentacionit bankar, kontratave të ngjashme, çmimeve referuese, rivlerësimit të pasurisë dhe elementeve të tjera të administruara në proces. Subjekti pretendoi se vendimi nuk analizon dhe nuk u jep përgjigje pretendimeve dhe provave të paraqitura prej tij, veçanërisht për çmimin e apartamentit të blerë në vitin 2004 dhe dokumentacionin mbi të ardhurat për blerjen e automjetit, ndërsa konkluzionet e shumicës së trupit gjykues për kriterin profesional, janë të paargumentuara dhe pa referenca konkrete ligjore. Sipas subjektit, këto mangësi krijojnë perceptimin e aplikimit të standardeve të dyfishta, cenojnë besimin e publikut në procesin e rivlerësimit dhe përbëjnë shkelje të standardeve të procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 dhe nenit 8 të KEDNj-së.
19. Trupi gjykues, në analizë të këtij shkak ankimi, thekson se vendimmarrja e Komisionit i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, çka adreson rëndësinë e nënvizuar nga GjEDNj-ja për krijimin e mekanizmave që mund të sigurojnë koherencën e praktikës dhe njësimin e jurisprudencës⁶. Në këto kushte, pretendimet e mësipërme, të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, do të analizohen në koherencë me jurisprudencën e Kolegjit, vlerësuar nën dritën e rrethanave të konstatuara dhe provave të administruara për çështjen konkrete, në përgjigje të shkaqeve të ankimit, në vijim në këtë vendim. Në këtë drejtim, trupi gjykues i Kolegjit nënvizon se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për cenim të procesit të rregullt ligjor, të lidhura me mungesën e arsytimit të vendimit të Komisionit, do të trajtohen në funksion të secilit shkak ankimi, në raport me provat dhe analizën juridike përkatëse.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

➤ *Në lidhje me pasurinë “apartament banimi”, me sipërfaqe 71,71 m², të ndodhur në bulevardin “{***}”, Vlorë:*

20. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si të padrejtë dhe të pabazuar konkluzionin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, pasi nuk ka deklaruar vlerën e saktë të përfitimit të pasurisë, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të kryer pagesën e çmimit të pasurisë apartament banimi, si dhe pagimin para kohe të kredisë bankare, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikave 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5,*

⁶ *Shih: Beian v. Romania (no. 1), §§ 37 dhe 39; Lupeni Greek Catholic Parish and Others v. Romania [GC], §§ 116-35).*

shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

21. Konkluzionin e mësipërm, Komisioni e ka bazuar në arsyetimin se: *Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën vetting për apartamentin e banimit, duke mos deklaruar vlerën e saktë të përfitimit të pasurisë, e vendos atë në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues ligjor lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se kjo passjell mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pagimin e kësaj pasurie të paluajtshme. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues ligjor lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e kredisë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se kjo passjell mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pagimin para kohe të kredisë bankare.*
22. Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit, sikurse dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me: (i) çmimin e blerjes së këtij apartamenti në datën 29.04.2004; (ii) burimin dhe mundësinë financiare të subjektit për pagimin e këtij çmimi, si dhe (iii) shlyerjen para kohe të kredisë bankare në ProCredit Bank, në datën 14.07.2009, duke pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se:
- 22.1. Të gjitha provat dhe argumentet e parashtruara nga subjekti, provojnë tej çdo dyshimi se çmimi i apartamentit është në shumën 3.500.000 lekë dhe vlera e paguar prej tij për çmimin e apartamentit së bashku me vlerën e mobilimit, është vetëm shuma 4.384.569 lekë, (ekuivalenti në lekë i shumës 34.300 euro) e transferuar në llogarinë bankare të shtetasës V. H. në datën 17.05.2004.
- 22.2. Shumica e trupit gjykues në Komision, ka çmuar me fuqi më të lartë provuese një dokument të panënshkruar, që s’ka asnjë vlerë ligjore, qoftë edhe një rregull të bankës, se sa dhjetëra prova apo dokumente me fuqi të plotë provuese që janë krijuar 12 vite përpara se të miratohej ligji nr. 84/2016, të cilat tregojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm, çmimin e apartamentit në vlerën 3.500.000 lekë.
- 22.3. Në rastin konkret, subjekti nuk ka kryer asnjë veprim fiktiv. Banka e ka miratuar kredinë në vlerën që ai ka kërkuar dhe ndoshta për të respektuar rregulloren e bankës, oficeri i kredisë ka përgatitur dokumentin “Housing summary”, i cili as nuk është nënshkruar. Edhe dokumenti “Kërkesë”, i nënshkruar nga bashkëshortja, duhet të jetë firmosur në morinë e dokumenteve të kërkuara për të “respektuar” ndoshta rregullin e bankës.
- 22.4. Rregulli i bankës apo faktet e pasqyruara në një dokument të panënshkruar nuk mund të kenë fuqi provuese dhe nuk mund të mbivlerësohen mbi të dhënat dhe faktet logjike dhe të lidhura midis tyre që gjenden të pasqyruara në aktet e tjera të administruara gjatë hetimit administrativ, si: (i) kontrata noteriale midis palëve, ku çmimi i apartamentit është element thelbësor; (ii) dokumentet zyrtare apo aktet nënligjore që përcaktojnë çmimin mesatar për m² në qytetin e Vlorës, në kohën e blerjes së apartamentit; (iii) kontrata të ngjashme të apartamenteve në të njëjtin pallat, të lidhura në të njëjtën periudhë kohore nga qytetarë të tjerë; (iv) rivlerësimin e kryer për këtë apartament 7 vite më vonë, nga ekspertë të pavarur;

(v) deklarimin e subjektit në deklaratat periodike vjetore; (vi) vlera e shitjes së apartamentit në vitin 2018 (14 vite nga momenti i blerjes), vlerë e cila është më e ulët se çmimi që përcakton Komisioni për këtë apartament.

23. Trupi gjykues, nga analizimi i pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim, në parashtrime, si dhe akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, konstaton dhe vlerëson si vijon.

• *Lidhur me çmimin e blerjes së këtij apartamenti në datën 29.04.2004:*

24. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Apartamenti me sipërfaqe 71,71 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë, është blerë sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.04.2004, në vlerën 3.500.000 lekë. Burimi i krijimit është deklaruar kredia nga ProCredit Bank, me vlerë 35.000 euro, dhënë sipas kontratës së huasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.05.2004, me kolateral apartamentin objekt vlerësimi.*

25. Në funksion të deklarimeve, subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, kontratën noteriale të shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.04.2004, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, znj. A. S., kanë blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, një apartament banimi të ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë, me sipërfaqe 71,71 m². Në këtë kontratë parashikohet se: *me marrëveshje mes palëve, kjo pasuri i kalon palës blerëse, me çmimin prej 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekësh të reja, shumë kjo e likuiduar plotësisht.*

26. Në deklaratën e interesave periodikë privatë (në vijim “DIPP”) të vitit 2004, subjekti ka deklaruar: *Shtëpi banimi me sip. 71,71 m². Ndërtuar në vitin 2003. Lagjja “{***}”, rruga “{***}”, Vlorë. Blerë nga firma “{***}”. Vlera: 3.500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Krijuar në datën 29.4.2004. Në këtë deklaratë, në seksionin e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar: *kredi bankare, datë 14.05.2004, në ProCredit Bank. Shuma e detyrimit e shlyer deri më 31 dhjetor, në vlerën 2.710 euro dhe shuma e mbetur deri në këtë datë, 50.940 euro.**

27. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2⁷, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se çmimi i blerjes nuk është paguar në datën e kontratës së shitblerjes, por pas marrjes së kredisë, në datën 17.05.2004, provuar nëpërmjet transfertës bankare nga llogaria e bashkëshortes A. D. (S.) drejt llogarisë bankare të shtetases V. H., si dhe ka paraqitur si dokument provues vërtetimin nr. {***}, datë 18.04.2024, të ProCredit Bank ShA.

28. Referuar akteve të administruara nga regjistri publik i pasurive të paluajtshme, ka rezultuar se pasuria objekt vlerësimi është rivlerësuar në datën 20.12.2011, në vlerën 4.323.969 lekë dhe në vijim, në datën 17.09.2018, i është shitur shtetases R. B. kundrejt çmimit 45.500 euro⁸.

29. Nga dokumentacioni i administruar mbi praktikën e kredisë⁹, ka rezultuar se midis huadhënësit ProCredit Bank dhe huamarrësve, z. Xhemal Saliaj dhe znj. A. S., është lidhur

⁷ Referoju përgjigjes 2 të këtij pyetësori.

⁸ Me kontratën noteriale nr. {***} rep., dhe {***} kol.

⁹ Administruar në Komision nëpërmjet shkresës kthim përgjigjeje të ProCredit Bank nr. {***}, datë 11.6.2024, protokolluar me nr. {***}, datë 12.06.2024.

kontrata e huasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.05.2004, me objekt: *Dhënie huaje në vlerën 35.000 euro, me afat shlyerjeje brenda një periudhe 120 mujore.* Në vijim, në datën 17.05.2004, rezulton se në llogarinë e bashkëshortes së subjektit është disbursuar shuma prej 34.300 eurosh, shumë e cila po në këtë datë ka kaluar në llogarinë e shtetas V. H.

30. Në raportin e analizës së oficerit të kredisë, në dokumentin e titulluar “Housing summary”, është shënuar¹⁰ se: (i) *Borxhi prej 4.445.000 lekësh është pjesa e mbetur e detyrimit për blerjen e shtëpisë së re të firma e ndërtimit.* (ii) *Klienti ka paguar një shumë prej 15.000 eurosh (1.905.000 lekë), nga të cilat 10.000 euro janë pagesë kësti, ndërsa 5.000 euro janë meremetime që e njëjta firmë ndërtimi do të bëjë tek apartamenti i ri, pasi më përpara ka banuar një familje tjetër, e cila ka bërë rregullime të ndryshme në shtëpi.*
31. Sa më sipër, Komisioni ka konstatuar mospërputhje ndërmjet shumës së transferuar në llogarinë e shtetas V. H. dhe çmimit të parashikuar në kontratën noteriale të shitblerjes, datë 29.04.2004. Konkretisht, ndërsa në kontratë palët kanë rënë dakord për çmimin 3.500.000 lekë, nga veprimet bankare ka rezultuar se është transferuar shuma 4.384.569 lekë, pra rreth 884.569 lekë më shumë se çmimi i parashikuar në kontratë.
32. Në vijim, Komisioni kreu analizën paraprake financiare për mundësitë e subjektit dhe personit të lidhur për të kryer pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit më 29.04.2004, duke iu referuar vlerës për blerjen e apartamentit prej 50.000 eurosh (35.000 euro nga kredia bankare dhe 15.000 euro parapagim), duke mos iu referuar kontratës së shitjes, por dokumentacionit të bankës në dosjen e kredisë. Në këtë analizë, Komisioni nuk ka përfshirë kredinë bankare si burim financiar, pasi nga kontrata e shitblerjes rezulton se çmimi është likuiduar brenda datës 29.04.2004, ndërkohë që kredia është disbursuar më vonë, në datën 17.05.2004. Në përfundim të kësaj analize paraprake, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur mundësi financiare në datën 29.04.2004, për pagimin e apartamentit me sipërfaqe 71,7 m², në vlerën 50.000 euro, për një diferencë prej (-) 6.032.692 lekësh.
33. Subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, për sa duket se: (i) *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit, pasi nga dokumentacioni rezultoi se subjekti i ka paguar shtetas V. H. më shumë se sa çmimi i vendosur në kontratë dhe, për rrjedhojë, çmimi, si kusht kontraktual, duket se është fiktiv dhe i vendosur në marrëveshje mes palëve sa vlera mesatare e aplikuar në tregun e lirë të apartamenteve në qytetin e Vlorës¹¹.* (ii) *Kredia bankare nuk duket të ketë shërbyer si burim krijimi për pagesën e çmimit të blerjes pasi, referuar kontratës së shitblerjes, çmimi është paguar plotësisht brenda datës 29.4.2004, ndërsa kredia rezulton të jetë disbursuar në datën 17.5.2004.* (iii) *Nga analiza financiare, duket se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për të blerë apartamentin me sip. 71,7 m² në çmimin prej 50.000 eurosh, në datën 29.4.2004, duke rezultuar me balancë negative në shumën prej (-) 6.032. 692 lekësh.*

¹⁰ Në faqen nr. 3.

¹¹ Shih udhëzimin nr. 1, datë 4.3.2004, të Kryeministrit “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K”.

34. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar se vlera e paguar shitëses, përfshin jo vetëm çmimin e apartamentit sipas kontratës (3.500.000 lekë), por edhe vlerën e mobilimit të tij. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se çmimi i paguar shitësit është kryer pas disbursimit të kredisë dhe se me shitësin është dakordësuar paraprakisht të shënohej në kontratë për çmimin e paguar plotësisht, me qëllim që pasuria të regjistrohej si hipotekë e radhës së parë në pronësi të kredimarrësit, si kusht i panegociueshëm nga banka për kreditimin e kredisë. Subjekti ka kundërshtuar si të pabazuar përlllogaritjen në shumën 50.000 euro të çmimit të pasurisë (kundërvlera e saj 6.350.500 lekë), duke pretenduar se nuk ka qenë në dijeni në lidhje me shënimin në dokumentin e titulluar “Housing Summary” dhe vlera e vendosur në dokumentacionin e administruar nga banka nuk përfaqëson qëndrimin zyrtar të bankës, pasi ky dokument është i panënshkruar nga ndonjë punonjës i saj dhe i pavulosur.
35. Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën e ProCredit Bank nr. {***} prot., datë 20.09.2024, ku sqarohet se: [...] në lidhje me materialin e titulluar “Housing summary” të datës 23.04.2004, ju sqarohet se ky material përmban shënime të brendshme të mbajtura në atë periudhë nga analisti i kredisë gjatë procesit të miratimit të kredisë. Këto shënime që gjenden në dosjen e kredisë, janë të panënshkruara nga ndonjë punonjës i bankës dhe pa vulën e bankës, dhe i pashoqëruar me ndonjë dokumentacion plotësues/vërtetues.
36. Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit dhe të vendimit objekt shqyrtimi, vëren se Komisioni ka arritur në këtë konkluzion pasi nuk i ka vlerësuar bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me çmimin e paguar për pasurinë, dhe mospërputhjet ndërmjet vlerës së kontraktuar dhe deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* (3.500.000 lekë), shumës së transferuar (4.384.569 lekë), si dhe vlerës së deklaruar në aplikimin për kredi (6.000.000 lekë). Pretendimet e subjektit mbi pavlefshmërinë e dokumentit “Housing Summary” nuk u pranuan, nga Komisioni, duke mbajtur në konsideratë faktin se, në formularin F-1H, titulluar “Kërkesë kredie për shtëpi”, dorëzuar bankës nga vetë bashkëshortja e subjektit, ajo ka deklaruar dhe firmosur në datën 08.04.2004, se vlera e investimit të tyre kishte kosto totale 6.000.000 lekë. Komisioni ka arsyetuar se jo vetëm i gjithë dokumentacioni bankar i administruar lidhur me këtë kreditim, duke përfshirë edhe deklarinimin e bashkëshortes së subjektit mbi vlerën e investimit, por edhe sa më sipër analizuar lidhur me vlerën e kreditimit dhe kolateralit në një marrëdhënie kreditimi, konfirmojnë se vlera e pasurisë së paluajtshme në deklaratën *vetting*, përmban deklarinim të rremë lidhur me çmimin e deklaruar, që nuk provohet dhe as mbështetet nga faktet e hetimit administrativ.
37. Në vijim, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, ashtu si dhe në deklaratën e interesave private të vitit 2004, e cila shërben si provë në këtë proces, ka deklaruar vlerën e blerjes së apartamentit, sipas vlerës së përcaktuar në kontratën noteriale të shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.4.2004. Dokumentet bankare të administruara në kuadër të procedurës së miratimit të kredisë, përfshirë “Housing Summary” dhe formularin “Kërkesë kredie për shtëpi”, duket të jenë akte pune të bankës dhe nuk shoqërohen me prova konkrete pagese, si mandate arkëtimi, transfertat bankare apo marrëveshje kontraktore, që të provojnë një çmim real më të lartë nga ai i pasqyruar në kontratën noteriale.
38. Po ashtu, referuar edhe shkresës së ProCredit Bank nr. {***} prot., datë 20.09.2024, konfirmohet se dokumenti “Housing Summary” përmban shënime të brendshme të punonjësit

të bankës, të panëshkruara dhe të pavulosura, të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion provues. Në këto kushte, këto akte nuk kanë vlerë provuese, dhe në çmimin e trupit gjykues nuk mjaftojnë për të zbehur vlerën provuese të kontratës noteriale të shitblerjes e cila ka vlerë të plotë provuese.

39. Diferenca ndërmjet shumës së transferuar dhe çmimit në kontratë, e shpjeguar nga subjekti si vlerë e mobilimit, në vlerësimin e trupit gjykues gjen mbështetje si në deklaratimet e subjektit ashtu dhe në dokumentacionin e praktikës së kredisë. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes nr. 9 të pyetësorit standard, *i pyetur mbi shpenzimet më të larta se 2.500 euro*, ndër të tjera ka deklaruar se ka paguar: *Apartament [...] + Mobilimin*.
40. Subjekti ka qenë konsistent në deklaratimet e tij dhe në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, ku ka deklaruar se apartamenti është blerë i mobiluar dhe se shuma e transferuar shtetases V. H., përfaqëson çmimin e kontratës, si dhe vlerën e mobilimit. Po ashtu, në kontratën e kredisë rezultojnë e dokumentuar se, përveç hipotekës mbi apartamentin, janë vendosur si pengje hipotekore edhe objekte/pajisje shtëpie, në shumën 250.000 lekë. Kjo e dhënë dokumenton se apartamenti ka qenë i mobiluar dhe i është shitur subjektit së bashku me mobilimin. Këto rrethana, të vlerësuara në tërësi dhe në lidhje logjike me njëra-tjetrën, e bëjnë të besueshëm pretendimin e subjektit se diferenca ndërmjet shumës së transferuar dhe çmimit të përcaktuar në kontratën noteriale të shitjes, lidhet me mobilimin e apartamentit.
41. Trupi gjykues vëren se, referuar Udhëzimit nr. 1, datë 04.03.2004 të Këshillit të Ministrave, çmimi mesatar i tregut të shitjes së pasurive të paluajtshme në Vlorë, në atë periudhë, ishte 48.636 lekë/m², ndërsa vlera e apartamentit për sipërfaqen 71,71 m², përlllogaritjet rreth 3.487.687 lekë, pra në përputhje me çmimin e përcaktuar në kontratën e shitjes. Ndërkohë që, nëse do të pranohej vlera e konstatuar nga Komisioni prej 50.000 eurosh, ekuivalenti në lekë 6.350.494, atëherë çmimi për m² do të rezultonte me vlerë 88.558 lekë/m², e cila mbështet pretendimin e subjektit se çmimi do të ishte ndjeshëm më i lartë se çmimi mesatar i shitjes së apartamenteve në qytetin e Vlorës në vitin 2004.
42. Nga aktet e administruara nga ASHK Vlorë, rezultojnë se pasuria objekt kontrolli është rivlerësuar në vitin 2011, në vlerën 4.323.969 lekë, e cila rezultojnë më e ulët se çmimi që Komisioni i ka dhënë kësaj pasurie në vitin 2004. Në vijim, në datën 17.09.2018, rezultojnë se kjo pasuri i është shitur me kontratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.09.2018, shtetases R. B., kundrejt vlerës prej 45.500 eurosh, vlerë e cila, bazuar në të dhënat e kursit zyrtar të këmbimit në datën e shitjes, arrin në shumën prej 5.763.030 lekësh, e cila sërish rezultojnë më e ulët se vlera e përlllogaritjet nga Komisioni për këtë pasuri. Gjithashtu, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka paraqitur kontrata të ngjashme shitblerjeje për apartamente të ndodhura në të njëjtin objekt ndërtimi, nga të cilat rezultojnë çmime të përafërta me atë të deklaruar prej tij, në pajtueshmëri me vlerën e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe kontratën e shitblerjes.
43. Lidhur me konstatimin e Komisionit mbi kreditimin nga banka në masën 70% të vlerës së pasurisë, rezultojnë se ky përfundim nuk mbështetet në një bazë të ligjore konkrete për vitin 2004, kohë kur politikat e kredidhënies janë vendosur nga vetë bankat, ndërkohë që akti i parë rregullator në lidhje për rregullimin e kredisë konsumatore dhe hipotekore është miratuar në

vitin 2009¹².

44. Nga dokumentacioni i kredisë, evidentohet se ProCredit Bank ka miratuar kredinë në shumën e kërkuar prej 35.000 eurosh, pas vlerësimit financiar dhe vendosjes së kolateralit nga subjekti dhe bashkëshortja. Apartamenti është vlerësuar në shumën 45.000 euro dhe është vendosur si garanci për shlyerjen e kredisë së bashku me garancinë e vendosur mbi pajisjet e mobilimit, vlerësuar në shumën 250.000 lekë. Nga formulari “*Financial project including DONE Investments*”, pjesë e praktikës së kredisë, rezulton se banka ka përllogaritur një investim total prej 50.000 eurosh, i përbërë prej shumës 35.000 eurosh hua, 10.000 euro parapagim dhe 5.000 euro riparime të ndryshme nga fonde të veta. Në këtë rubrikë, referohet dhe përrshkrimi “*Share of client contribution in overall project (in %): 30%*”.
45. Referuar akteve të mësipërme, duket se banka referon se kontributi i subjektit në këtë investim, është në masën 30%, dhe se banka ka përllogaritur kredidhënien në masën 70% të vlerës së investimit prej 50.000 eurosh, në shumën 35.000 euro (50.000 euro x 70% = 35.000 euro). Deklarimi në dokumentacionin bankar për një vlerë më të lartë investimi, në vlerësimin e trupit gjykues lidhet me procedurat dhe kërkesat e financimit bankar. Këto të dhëna nuk provojnë, në vetvete, se çmimi real i pasurisë ka qenë i ndryshëm nga ai i përcaktuar në kontratën noteriale. Në vlerësimin e trupit gjykues, ato lidhen me strukturimin e financimit dhe shpenzimet përkatëse të investimit. Formulari kërkesë për kredi (në shumën 6.000.000 lekë), rezulton të jetë hartuar 20 ditë përpara hartimit të kontratës së shitblerjes së apartamentit të datës 29.04.2004 (në shumën 3.500.000 lekë), dhe duket se sjellja e subjektit të rivlerësimit është formatuar sipas kërkesave të bankës, për nevoja të kredidhënies.
46. Ky vlerësim mbështetet dhe në faktin se, nga hetimi administrativ i Komisionit, nuk është administruar ndonjë akt provues për pagimin nga subjekti të shumës prej 15.000 eurosh si parapagim.
47. Trupi gjykues, referuar situatës faktike të konstatuar më sipër, çmon se konkluzioni i Komisionit se çmimi i blerjes së apartamentit nga subjekti është 50.000 euro, duke u bazuar vetëm në dokumentacionin e hartuar nga banka në funksion të dhënies së kredisë, nuk bazohet në një vlerësim tërësor të provave dhe rrethanave konkrete të marrjes së kredisë.
48. Sa më sipër, për pasurinë “apartament banimi”, me sipërfaqe 71,71 m², të ndodhur në bulevardin “{***}”, Vlorë, trupi gjykues gjeti të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se çmimi i blerjes së këtij apartamenti në datën 29.04.2004, është ai i përcaktuar në kontratë, në vlerën 3.500.000 lekë.
 - Lidhur me mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për pagimin e çmimit të blerjes:
49. Subjekti ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur*

¹² Në faqen zyrtare në internet të Bankës së Shqipërisë, gjendet vendimi nr. 48, datë 01.07.2015, “Për miratimin e rregullores “Për kredinë konsumatore dhe hipotekare”, e cila ka shfuqizuar rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe hipotekare për individët, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 05, datë 11.02.2009:

https://www.bankofalbania.org/Rreth_Bankes/Legjislacioni/Aktet_nenligjore/Rregullorja_Per_kredine_konsumatore_dhe_kredine_hipotekare.html.

të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me burimet financiare të krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme në vitin 2004, duke mos provuar mundësinë financiare që, me të ardhura të ligjshme, të mundësonte pagimin e çmimit të kësaj pasurie. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting, mbi vlerën e përfitimit të pasurisë, e vendos atë në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

50. Komisioni, konkluzionin e arritur më sipër, e ka bazuar në arsyetimin se mbeti e paprovuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për përfitimin e kësaj pasurie me çmim 50.000 euro, pasi edhe në rast se do të merrej në konsideratë se kredia e përfituar pas kontratës së shitblerjes, ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me pamundësi financiare për pagesën e vlerës prej 15.000 eurosh në vitin 2004.
51. Në lidhje me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit, i qëndron faktit se çmimi në kontratën e shitblerjes është 3.500.000 lekë, i cili është likuiduar nëpërmjet kredisë bankare të disbursuar më datë 17.05.2004. Sipas subjektit, provat e paraqitura prej tij provojnë tej çdo dyshimi se ky apartament është financuar nëpërmjet kredisë dhe se për të është paguar shuma 3.500.000 lekë. Nga analiza financiare, rezulton se balanca për pagesën e çmimit të këtij apartamenti rezulton pozitive, në vlerën 317.808 lekë.
52. Trupi gjykues vëren se ky konkluzion i Komisionit lidhet ngushtësisht me vlerësimin e tij, se pasuria objekt kontrolli ka kushtuar 50.000 euro dhe, nisur nga kjo premisë, ka vlerësuar se edhe nëse kredia do të konsiderohej si burim për krijimin e pasurisë, gjithsesi subjekti do të rezultonte me pamjaftueshmëri financiare.
53. Nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, rezulton se shuma e disbursuar nga banka më datë 17.05.2004, është transferuar në llogarinë bankare të shitëses së apartamentit, çka provon në mënyrë të drejtpërdrejtë destinacionin e kredisë si burim për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi. Në këto kushte, fakti që në kontratën e shitblerjes është pasqyruar se “shuma është likuiduar plotësisht”, nuk përbën element që vendos në dyshim burimin financiar të pasurisë, për sa kohë nga dokumentacioni bankar provohet se kredia është përdorur për pagesën e apartamentit. Për rrjedhojë, në vlerësimin e trupit gjykues, kredia bankare rezulton e provuar si burim i ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie dhe nuk ekziston asnjë rrethanë objektive që të çojë në një përfundim të kundërt.
54. Po ashtu, sikundër është arsyetuar më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se çmimi i blerjes së apartamentit është 3.500.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, për rrjedhojë nuk qëndron as konkluzioni i Komisionit për pamundësi financiare, i mbështetur mbi premisën se apartamenti është përfituar përkundërt çmimit prej 50.000 eurosh.
55. Në kushtet kur kredia bankare konsiderohet si burim i ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie, analiza financiare e kryer nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, rezultoi me balancë pozitive dhe, si rrjedhojë, nuk u gjend i drejtë vlerësimi i Komisionit se lidhur me këtë pasuri, subjekti ka bërë deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a”

dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

• *Lidhur me likuidimin e parakohshëm të kredisë bankare në ProCredit Bank:*

56. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare për të kryer pagesën prej 22.005 eurosh në datën 14.07.2009, për shlyerjen para kohe të kredisë.*

57. Këtë konkluzion, Komisioni e ka bazuar në arsyetimin se të ardhurat e pretenduara nga subjekti, përfituar si hua nga motra, nuk mund të përfshihen në analizën financiare si burim për shlyerjen para kohe të kredisë, pasi subjekti dështoi të bindte trupin gjykues mbi burimin e ligjshëm të krijimit të huasë. Në lidhje me sa më sipër, Komisioni ka arsyetuar se:

- [...] *Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës pas kalimit të rezultateve të hetimit administrativ, rezultoi se motra e subjektit është martuar me shtetasin J. K. në datën 26.2.2007 dhe se në përbërjen e gjendjes civile, përveç motrës së subjektit dhe bashkëshortit të saj, rezultoi edhe djali i bashkëshortit të motrës së subjektit, shtetasi Th. K., i datëlindjes 5.11.1988.*

- *Të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti i motrës së subjektit, në shumën 36.111 euro, u konsideruan, referuar të dhënave të depozituara nga vetë subjekti, të mjaftueshme vetëm për mbulimin e shpenzimeve minimale jetike të tij dhe djalit të tij, për vitet 2002 – 2008.*

- *Fragmentimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit lidhur me të ardhurat e krijuara nga motra dhe bashkëshorti, duke nisur nga viti 2002 dhe duke u ndalur te shpenzimet jetike minimale të tyre, pa marrë në konsideratë shpenzimet jetike të djalit të bashkëshortit të huadhënëses, nuk provon se ata kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar kursime nga të ardhurat e tyre, të provuara, për sa i përket ligjshmërisë për t'ia dhënë hua subjektit të rivlerësimit.*

- *Trupi gjykues arrin në përfundimin se në raport me legjislacionin e zbatueshëm, në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë këtë status, subjekti nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të huasë në shumën 17.000 euro, përdorur prej tij për shlyerjen para kohe të huasë bankare.*

- *Këto të ardhura nga puna, të krijuara nga motra dhe bashkëshorti i saj, duke nisur disa vite para se ata të lidhnin martesën, janë konsideruar nga trupi gjykues të mjaftueshme vetëm për mbulimin e shpenzimeve minimale jetike të personave të huadhënësve, përkatësisht në vitet 2002 – 2007 për bashkëshortin e ardhshëm të motrës dhe djalin e tij, në vitet 2002 – 2007 për motrën e subjektit, ndërsa pas martesës së tyre, në vitet 2007 – 2008, për motrën, bashkëshortin e saj dhe djalin e tij, duke rezultuar për rrjedhojë të pamjaftueshme për të mundësuar kursimin, për t'iu dhënë në vijim subjektit në formën e huasë për shlyerjen e kredisë bankare [...].*

58. Në kundërshtimin si të padrejtë e të pabazuar të konkluzionit të mësipërm, subjekti ka pretenduar se:

(i) Subjekti ka arritur të provojë mundësinë financiare të familjes së motrës për dhënien e huasë. Bazuar në jurisprudencën e Komisionit dhe Kolegjit, analiza financiare e personit tjetër

të lidhur duhet të bëhet deri në masën e shumës së dhënë hua. Sipas subjektit, motra e tij ka pasur mundësi financiare për t'i dhënë atij hua në shumën 17.000 euro, në muajin qershor 2009.

(ii) Në lidhje me shpenzimet e jetesës së motrës së tij, subjekti ka pretenduar se përfshirja e djalit të bashkëshortit të huadhënëses në shpenzimet jetike (pra tre persona) në analizën e Komisionit, nuk është e drejtë. Sipas tij, djali i bashkëshortit të huadhënëses (thjeshtri i motrës së subjektit) ka lindur në vitin 1988, dhe nga viti 2003 deri në vitin 2006, kur arriti moshë madhore, është suportuar financiarisht nga asistenca e nënës së vdekur, me vlerë 499 euro/muaj.

(iii) Analiza financiare për shlyerjen e kredisë në datën 14.07.2009, rezulton me një balancë negative në shumën (-) 437.983 lekë, ndërsa deri në fund të vitit, ajo del pozitive. Balanca negative e muajit korrik 2009, sipas subjektit, lidhet me faktin se ai dhe bashkëshortja e tij nuk kanë deklaruar gjendjen *cash* ndër vite. Pavarësisht mosdeklarimit të kursimeve *cash* dhe i vetëdijshëm në lidhje me jurisprudencën e organeve të rivlerësimit sa i takon mosdeklarimit të saj, subjekti pretendon se balanca pozitive në fund të vitit 2008, në shumën (+) 1.028.199 lekë, tregon se gjendja e kursimeve *cash* në familje nuk ka qenë 0 (zero). Po ashtu, sipas tij, balancat pozitive në fund të çdo viti duhet të merren në konsideratë në kuadër të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit. Diferenca negative në analizën financiare për shlyerjen e parakohshme të kredisë, bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

59. Trupi gjykues, në shqyrtim të pretendimeve të mësipërme, nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe nga kontrolli i arsytimit në vendim, konstatoi si vijon.
60. Në deklaratat periodike të interesave private të viteve 2004-2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar rregullisht shlyerjen e detyrimit të kredisë të marrë në ProCredit Bank, si dhe pjesën e mbetur të pashlyer.
61. Në DIPP -2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka shlyer totalisht kredinë. Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar se, me *kontratë huaje, datë 25.06.2009*, ka marrë hua nga J. S. (K.), shumën 17.000 euro, për tri vite, me interes zero (0). Në kontratën e thjeshtë të huasë, datë 25.06.2009, lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe motrës së tij, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, deklarohet se kjo e fundit i ka dhënë hua vëllait të saj shumën prej 17.000 eurosh, me kushte kthimi për tri vite, me tri këste të barabarta, duke filluar nga data 25.06.2010.
62. Gjatë hetimit administrativ në Komision¹³, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, deri në datën 14.07.2009, kanë pasur detyrim ndaj bankës shumën 21.631 euro, të cilën e kanë shlyer para kohe, po në këtë datë, nëpërmjet depozitimit *cash* të shumës 22.005 euro, me përshkrimin: "Derdhje për mbyllje kredie".
63. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, i pyetur nga Komisioni *nëse ka marrë*

¹³ Shkresë me nr. {***} prot., datë 30.5.2004, e Komisionit dhe shkresë kthim përgjigjeje e ProCredit Bank me nr. {***}, datë 11.6.2024, me nr. {***} prot., datë 12.6.2024, shkresë e hetimit nga dosja e ILDKPKI-së, si dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit II.

*ndonjëherë borxh nga një person apo shoqëri private, ka sqaruar se në vitin 2009 ka marrë hua nga motra e tij, J. S. (K.), shumën 17.000 euro, e cila zotëronte të ardhura të ligjshme dhe të tatuara (33.110,67 euro), të siguruara nga puna në Greqi, gjatë viteve 2002 – 2008, si dhe ka paraqitur kontratën me shkresë të thjeshtë të marrjes së huasë, datë 25.06.2009, dhe deklaratën e motrës me shkrim dore, të shtatorit 2012, për shlyerjen e detyrimeve, në të cilën deklaroi se: *kontrata e mësipërme është realizuar me sukses, brenda afatit të përcaktuar.**

64. Në vijim, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, ka shpjeguar se huaja nga e motra është marrë për të shlyer kredinë prej 35.000 eurosh, pra këstin e fundit në shumën prej 21.631 eurosh. Në këtë shumë, ka shpjeguar subjekti, përfshihet huaja e marrë nga motra dhe pjesa tjetër nga kursime familjare. Huaja është marrë për një afat 3-vjeçar dhe është shlyer për tre viti (2010-2013), përkatësisht për vitin 2010 dhe 2011, ka shlyer nga 6.000 euro, ndërsa për vitin 2012 ka deklaruar se ka shlyer 5.000 euro, shlyerje të cilat janë deklaruar dhe në deklaratat periodike respektive. Subjekti paraqiti dokumentacion justifikues në lidhje me të ardhurat bruto të motrës, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore të Republikës së Greqisë për periudhën 2002-2008.
65. Komisioni, në analizë të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me të ardhurat bruto të shtetas J. S. (K.), të përfituara nga punësimi në shtetin grek, konstatoi se për periudhën 2002-2008, të ardhurat në total janë në shumën 32.665 euro bruto, ndërkohë që, referuar të dhënave të Eurostat-it¹⁴, shpenzimet minimale për një person për vitet 2003-2008 (pasi për vitin 2002 nuk ka të dhëna) rezultojnë të jenë në shumën 22.927 euro. Sa më sipër, Komisioni konstatoi se shtetasja J. S. (K.) nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të dhënë hua shumën prej 17.000 eurosh subjektit të rivlerësimit e, për rrjedhojë, nuk e ka konsideruar huanë e marrë nga motra si burim për shlyerjen e parakohshme të kredisë.
66. Në këto kushte, Komisioni përgatiti analizën financiare për mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur me të, për të kryer pagesën për shlyerjen e parakohshme të kredisë në datën 14.07.2009 dhe i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi duket se ai dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të kryer pagesën e shumës 22.005 euro në datën 14.07.2009, duke rezultuar me një balancë negative, në shumën (-) 2.769.873 lekë.
67. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, ka kërkuar që në analizën financiare, përveç të ardhurave të motrës, të konsiderohen edhe të ardhurat e bashkëshortit të saj, të cilat, për periudhën 2002 – 2008, janë në shumën 36.111 euro. Nëse këtyre të ardhurave do t'u zbritej shuma e shpenzimeve jetike gjatë kësaj periudhe për bashkëshortin, prej 22.927 eurosh, sipas subjektit, shuma e mbetur do të ishte 13.184 euro. Subjekti ka pretenduar se motra dhe bashkëshorti i saj kanë pasur kursime familjare të mjaftueshme për të dhënë hua shumën 17.000 euro, në qershor të vitit 2009 (shuma e disponuar përkatësisht 9.738 euro për motrën dhe 13.184 euro për bashkëshortin e saj). Bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, sipas vendimit (JR) nr. 2/2023, arrihet në konkluzionin se motra e tij ka pasur mundësi që nga kursimet familjare t'i japë subjektit huanë, në shumën 17.000 euro. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave, certifikatën e gjendjes familjare të shtetasit

¹⁴ <https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/bookmark/e7c7d699-f226-4926-9b45-55e59f53caad?lang=en>

J. K. dhe dokumentacion nga Institucioni i Sigurimeve Shoqërore të Republikës së Greqisë për shtetasit J. K. dhe J. K.

68. Sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në funksion të deklaramëve të tij, i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, kontratën e thjeshtë të huasë, datë 25.06.2009, si dhe ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore si marrjen e huasë në shumën 17.000 euro nga motra e tij, ashtu edhe shlyerjen e saj në deklaratat periodike për vitet 2010 – 2012. Në kushtet kur deklaramet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, përdoren si provë nga institucionet e rivlerësimit, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së Kolegjit, fakti që këto veprime kanë lënë gjurmë jo vetëm në deklaratën e pasurisë *vetting*, por dhe në deklaramet e subjektit ndër vite, në vlerësimin e trupit gjykues, për efekt të këtij procesi, e bën të besueshme ekzistencën e kësaj marrëdhënieje.
69. Referuar certifikatës së gjendjes familjare, të administruar në fashikullin e Komisionit, rezulton se motra e subjektit është martuar në datën 26.02.2007, me shtetasin J. K., i cili kishte një fëmijë nga martesja e mëparshme të datëlindjes 05.11.1988. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se analiza e mundësisë financiare të huadhënësës për krijimin e shumës 17.000 euro, duhet të kryhet në mënyrë të integruar mbi bazën e të ardhurave familjare të krijuara nga bashkëshortët pas lidhjes së martesës, duke marrë në konsideratë edhe shpenzimet minimale jetike përkatëse. Në këtë kuadër, për periudhën përpara lidhjes së martesës, mundësia për kursim duhet analizuar mbi të ardhurat dhe shpenzimet individuale të secilit bashkëshort, ndërsa pas martesës mbi të ardhurat dhe shpenzimet e njësisë familjare.
70. Nga rezultatet e hetimit administrativ dhe arsyetimi i vendimit të Komisionit, rezulton se subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të motrës së tij dhe bashkëshortit të saj, për një periudhë relativisht të gjatë kohore, përfshirë edhe vite kur këta të fundit nuk kanë qenë të martuar. Në vlerësimin e trupit gjykues, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit dhe të GjEDNj-së¹⁵, në raste të tilla nuk mund të kërkohej i njëjti standard provueshmërie që zbatohet ndaj subjekteve të rivlerësimit apo personave të lidhur me ta, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Kjo, pasi problematikat që lidhen me provueshmërinë e të ardhurave ose pasurive të krijuara nga persona të tretë, veçanërisht për periudha para lidhjes së martesës, duhet të vlerësohen në raport me parimin e proporcionalitetit dhe qëllimet legjitime të ndjekura nga procesi i rivlerësimit.
71. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se bashkëshorti i motrës së tij ka përfituar pension në shumën 499 euro/muaj, kjo vlerë nuk konfirmohet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ. Megjithatë, referuar dokumentit të lëshuar nga Agjencia Kombëtare Elektronike e Sigurimeve Shoqërore dhe Pensioneve të Greqisë, datë 23.06.2025, si dhe rrethanave konkrete të çështjes, trupi gjykues çmon se provohet në nivel bindës ekzistenca e të ardhurave të përfituara nga shtetasi J. K. si pension familjar, për shkak të vdekjes së bashkëshortes së mëparshme, për periudhën 01.06.2003 – 01.03.2007. Në këto kushte, ndonëse nuk rezulton e provuar shuma konkrete e pretenduar nga subjekti, Kolegji

¹⁵ Në çështjen *Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë*.

vlerëson se duhet të merret në konsideratë fakti i njohur dhe i provuar, se familja e huadhënësës ka pasur të ardhura nga kjo skemë pensioni, të cilat kanë ndikuar në përbalimin e kostove të jetesës së fëmijës së mitur.

72. Në një qasje të orientuar drejt garantimit të një vlerësimi sa më objektiv dhe të favorshëm për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues çmon se të ardhurat e përfituara nga pensioni familjar në emër të fëmijës, duhet të reflektohen në analizën financiare. Megjithatë, ky reflektim nuk mund të bëhet në masën e plotë të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, por të paktën nëpërmjet reduktimit me 50% të shpenzimeve jetike të përlllogaritura për fëmijën. Ky vlerësim mbështetet në prezumimin logjik se pensioni pas vdekjes ka shërbyer, të paktën pjesërisht, për mbulimin e kontributit që prindi i ndjerë do të kishte dhënë për rritjen dhe mirëqenien e fëmijës, duke pasur parasysh se, në rrethana normale, shpenzimet e jetesës së tij përballohen nga të dy prindërit. Për rrjedhojë, për efekt të analizës financiare, për fëmijën duhet të përlllogariten shpenzime jetike në masën e gjysmës së shpenzimeve të një personi.

72.1. Nga verifikimi i kryer në Kolegj nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues konstaton se mundësia financiare e motrës së subjektit për dhënien e huasë në vlerën 17.000 euro, e përlllogaritur në dy periudha dhe duke mbajtur në konsideratë përbërjen e saj familjare para dhe në kohën e dhënies së huasë, rezulton si më poshtë.

72.2. Për periudhën 01.01.2003 - 26.02.2007, bazuar në të ardhurat prej 22.771 eurosh të motrës së subjektit, duke zbritur shpenzimet e jetesës të llogaritura për një person, prej 15.207 eurosh¹⁶, mundësia e kursimit rezulton në vlerën prej 7.564 eurosh.

72.3. Për periudhën 2002 - 02/2007, të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i motrës së subjektit, referuar akteve në fashikull, janë në shumën 26.707 euro, kurse shpenzimet e jetesës janë 15.207 euro për bashkëshortin e motrës së subjektit, së bashku me gjysmën e shpenzimeve të jetesës për djalin e tij në shumën 7.604 euro, duke përlllogaritur shpenzime totale në shumën 22.811 euro¹⁷. Për rrjedhojë, mundësia financiare e tij për kursim për këtë periudhë, u përlllogarit në shumën 3.897 euro¹⁸.

72.4. Për periudhën në vijim, 02/2007 – 2008, për familjen e përbërë prej 3 personash (motra, bashkëshorti dhe djali i tij), shpenzimet për jetesë për 3 persona, në shumën prej 23.160 eurosh¹⁹, rezultuan më të larta se të ardhurat e përlllogaritura për të dy bashkëshortët, në shumën 19.305 euro, duke rezultuar me pamundësi financiare për të kursyer.

72.5. Për rrjedhojë, mundësia e kursimit për motrën e subjektit së bashku me bashkëshortin e saj përlllogaritet në shumën 11.461 euro.

¹⁶ Referuar të dhënave nga Eurostat-i: [\[ilc_li01\] At-risk-of-poverty thresholds](#), shpenzimet jetike minimale për person në shtetin grek, për periudhën 01.01.2003 – 26.02.2007, rezultojnë në shumën 15.207 euro (3.282 euro viti 2003 + 3.538 euro viti 2004 + 3.767 euro viti 2005 + 3.940 euro viti 2006 + 680 euro¹⁶ viti 2007 = 15.207 euro).

¹⁷ 15.207 euro + 7.604 euro = 22.811 euro.

¹⁸ 26.707 euro të ardhura – 22.811 euro shpenzime jetike = 3.897 euro.

¹⁹ Shpenzime jetike për tre persona në shumën 10.200 euro në periudhën mars 2007 - dhjetor 2007, pra 10 muaj [4.080 euro x 3 persona] ÷ 12 muaj x 10 muaj = 10.200 euro, shuma 12.960 euro në vitin 2008 [4.320 euro x 3 persona = 12.960 euro], në total në shumën 23.160 euro për këtë periudhë.

73. Nga rishikimi i analizës financiare të Komisionit nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor lidhur me mundësinë e subjektit për shlyerjen e kredisë bankare në datën 14.07.2009, duke përlllogaritur në zërin “Të ardhura nga huaja e motrës” shumën prej 11.461 eurosh²⁰, e përlllogaritur si mundësi kursimi e motrës së subjektit, rezulton një balancë negative në shumën (-) 1.290.716 lekë.

74. Trupi gjykues vlerëson se kjo balancë negative, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, si dhe në konsideratë të rrethanave specifike të çështjes kur ajo nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me subjektin e rivlerësimit, por me provueshmërinë e mundësisë financiare të motrës dhe bashkëshortit për t'i dhënë huanë në shumën 17.000 euro, nuk duhet të pasjellë përgjegjësi disiplinore për subjektin e rivlerësimit.

75. Në përfundim të analizimit të shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, bazuar në konstatimin e mësipërm të situatës faktike dhe legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues arriti në përfundimet e mëposhtme.

75.1. Për pasurinë “*apartment banimi*”, me sipërfaqe 71,71 m², të ndodhur në bulevardin “{***}”, Vlorë, trupi gjykues gjeti të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se çmimi i blerjes së këtij apartamenti në datën 29.04.2004, është ai i përcaktuar në kontratën noteriale, në shumën 3.500.000 lekë, dhe si burim financiar për pagimin e këtij çmimi, ka shërbyer kredia e marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, si person i lidhur, në ProCredit Bank me kontratën e huasë së datës 17.05.2004. Për rrjedhojë të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

75.2. Lidhur me shlyerjen para kohe të kredisë bankare pranë ProCredit Bank, në datën 14.07.2009, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 1.290.716 lekë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Megjithatë, në vlerësim të trupit gjykues dhe në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, kjo mungesë nuk arrin një nivel të tillë që të çojë në konkluzionin se deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i pamjaftueshëm, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

➤ Për pasurinë automjet “*Mercedes Benz*”, me targë {***}:

76. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se *subjekti i rivlerësimit nuk arriti t'i provojë trupit gjykues të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke u gjendur në parashikimet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. [...] ka përfituar nga statusi i nënës së tij si invalide, me qëllim krijimin e lehtësirave fiskale për blerjen dhe gëzimin e kësaj pasurie, duke sjellë për rrjedhojë cenim të etikës dhe integritetit të tij si prokuror, pasi kjo mënyrë sjelljeje e zgjedhur prej tij, duket se tregon një qasje të caktuar në raport me respektimin e ligjit [...]. Sjellja e jashtme, për shkak të rëndësisë*

²⁰ Konvertuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë në datën 14.07.2009, në shumën 1.479.157 lekë (11.461 euro x 129,06 lekë/euro = 1.479.157 lekë).

që ka besimi i publikut tek autoriteti i sistemit të drejtësisë, është objekt rregullimi i normave të etikës së prokurorit dhe pjesë e standardeve që udhëzojnë shembuj më të mirë të sjelljes dhe integritetit. Në këtë kuptim, kjo çështje u vlerësua të merret në konsideratë në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kritereve sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

77. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit ka përfitur nga statusi i nënës së tij si invalide për të përfitur lehtësitë fiskale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për blerjen dhe përdorimin e mjetit. Sipas Komisionit, një sjellje e tillë cenon etikën dhe integritetin që kërkohet nga një magjistrat dhe, për këtë arsye, është marrë në konsideratë në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të të tria kritereve të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
78. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankimin e tij se Komisioni e ka vlerësuar në mënyrë të padrejtë faktin e blerjes së automjetit në emër të nënës së tij tetraplegjike si një rrethanë që cenon besimin e publikut te drejtësia, në kuptim të nenit 2, pika 4 e ligjit nr. 86/2016. Sipas subjektit, ky përfundim është jologjik dhe në kundërshtim me provat e administruara, ligjin dhe jurisprudencën e konsoliduar të institucioneve të rivlerësimit, pasi: (i) provat e paraqitura prej tij provojnë mundësinë financiare të nënës për blerjen e automjetit; (ii) përfundimi i Komisionit se ka mbetur i paprovuar përdorimi i automjetit nga nëna e subjektit, është alogjik, pasi kjo e fundit, për shkak të statusit të saj si person tetraplegjik, e kishte të pamundur ta përdorte personalisht automjetin, ndërsa legjislacioni në fuqi i njeh kësaj kategorie personash të drejtën për të pasur në pronësi një automjet në funksion të nevojave të tyre, përdorimi i të cilit realizohet domosdoshmërisht nga familjarët ose persona të tjerë që kujdesen për ta. Në këtë drejtim, subjekti ka theksuar se arsyet e përdorimit të automjetit janë përcaktuar edhe në dokumentin noterial të vitit 2010, të hartuar përpara fillimit të procesit të rivlerësimit, si dhe se bëhet fjalë për një automjet të përdorur me vlerë 2.200 euro; dhe (iii) nevoja e një personi tetraplegjik për kryerjen e vizitave dhe kontrolleve mjekësore përbën një rrethanë që buron nga vetë gjendja e tij shëndetësore dhe nuk kërkon provë të posaçme. Subjekti pretendon se ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me përdorimin e automjetit, duke përjashtuar dyshimin se ai përbën një pasuri të fshehur të tij, ndërkohë që përdorimi i automjetit është deklaruar prej vetë subjektit të rivlerësimit.
79. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstaton si në vijim.
80. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Automjet, tip “Mercedes Benz”, viti i prodhimit 1997. Targë: {***}. Leje qarkullimi: {***}, lëshuar për znj. H. A. S. Viti i lëshimit të lejes së qarkullimit: 29.10.2010. Në përdorim.*
81. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetim nr. {***} prot., datë 24.09.2010, lëshuar nga Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, sipas të cilit znj. H. A. S. ka përfitur statusin e invalidit paraplegjik-tetraplegjik, duke u përfshirë në përfitimet e parashikuara nga ligji nr. 8626, datë 22.06.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (në vijim “ligji nr. 8626/2000”), si dhe rezulton të ketë në pronësi automjetin e llojit autoveturë me nr. shasie {***}.

82. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRr”), me shkresën nr. {***} prot., datë 16.04.2024, ka përcjellë në Komision fotokopjen e dosjes së njësuar me origjinalin të automjetit me targë {***}, në pronësi të shtetases H. A. S. Nga aktet, rezulton se në datën 08.06.2010, është lidhur aktmarrëveshje midis palës shitëse A. M. dhe palës blerëse H. S., për blerjen e automjetit objekt vlerësimi, i blerë në Gjermani kundrejt çmimit 2.200 euro. Në kohën e blerjes së automjetit, sipas librezës së identitetit për përfituesit e statusit të invalidit, datë 27.04.2010, nëna e subjektit gëzonte statusin e invalides paraplegjike të grupit të parë dhe, për shkak të këtij statusi, përfitonte lehtësitë e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, duke qenë e përjashtuar²¹ nga taksa doganore mbi automjetin, si dhe nga detyrimet e tjera, të cilat, sipas deklaratës doganore të datës 27.09.2010, arrijnë vlerën 515.620 lekë²².
83. Pjesë e kësaj praktike, është edhe deklarata noteriale nr. {***} rep., datë 10.9.2010, lëshuar nga kujdestari ligjor i nënës së subjektit, z. H. S., i cili deklaron se ai është dakord që automjetin në pronësi të H. S. ta përdorë, drejtojë dhe qarkullojë Xhemal Saliaj, duke i kaluar këtij të fundit të drejtat dhe përgjegjësitë ligjore që lidhen me drejtimin, përdorimin dhe mbajtjen e mjetit. Në të njëjtën deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *do të jetë i gatshëm t'i shërbejë të sëmurës H. S. për transportimin e saj në çdo kohë dhe vend që ajo të ketë nevojë.*
84. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, i pyetur nga Komisioni *nëse gjatë periudhës së deklaramit, ka përdorur ndonjëherë prona të regjistruara në emrin e dikujt tjetër*, ka deklaruar se e ka përdorur këtë automjet, për periudhën 2010-2016²³, periudhë në të cilën subjekti i rivlerësimit ka banuar në Vlorë, ndërsa nëna e subjektit ka banuar në {***}, Përmet, në një distancë mbi 130 km nga qyteti i Vlorës.
85. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, barrën e provës në lidhje me konstatimet se:

²¹ Ligji nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar, rregullon trajtimin e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe krijimin e përfitimeve të mundshme me qëllim që ata të marrin pjesë njëjllor si të tjerët në jetën shoqërore. Në nenin 16 të këtij ligji, parashikohet se personat e sëmurë paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga taksat doganore për mjete, të cilat ndihmojnë në integrimin e tyre në jetë, përfshirë këtu dhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre. Në nenin 6 të tij parashikohet se “të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta”. VKM-ja nr. 387, datë 31.5.2001 “Për përjashtimin nga taksat dhe tatimet të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë”, e dalë në bazë dhe zbatim të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Për efekt të zbatimit të nenit 6 të ligjit nr. 8626, dt.22.6.2000, të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga këto taksa: (i) taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve; taksa për pajisjen me dëshmi aftësie për drejtim automjeti”.

²² Referuar kartelës së mjetit, regjistrimi i parë i këtij mjeti është bërë pa taksë doganore.

²³ Referuar informacionit nga ISSH, nëna e subjektit të rivlerësimit ka ndërruar jetë më datë 28.04.2016. Nga informacioni i AMF-së, duket se subjekti i rivlerësimit ka bërë sigurim të automjetit objekt shqyrtimi deri më datë 24.04.2016. Komisioni nuk duket të ketë hetuar më tej në drejtim të periudhës së përdorimit të këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit.

(i) Subjekti ka detyrimin që për shkak të tagrit të përdorimit, të shpjegojë bindshëm si dhe të provojë me dokumentacion ligjor ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e automjetit nga e ëma, H. S.

(ii) Subjekti duhet të deklarojë çdo shpenzim të mundshëm të kryer për periudhën që e ka pasur në përdorim këtë automjet, bazuar në tagrat e përcaktuar në aktin e përdorimit, datë 10.9.2010.

(iii) Ngrihen dyshime të arsyeshme për fshehje pasurie nga subjekti i rivlerësimit, duke qenë se gjatë hetimit u provuan këto fakte: a) përdorimi i automjetit nga subjekti që nga momenti i blerjes së tij; b) distanca e largët rrugore e cila e bën të vështirë dhe gati të pamundur shërbimin e transportit në çdo kohë të një personi me nevoja të posaçme, siç është e ëma, invalide paraplegjike e grupit të parë.

(iv) Duket se subjekti ka përfituar nga statusi i nënës së tij si invalide, me qëllim krijimin e lehtësirave fiskale për blerjen dhe gëzimin e kësaj pasurie, duke sjellë për rrjedhojë cenim të etikës dhe integritetit të tij si prokuror.

86. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, ka shpjeguar se nëna e tij ka pasur mjaftueshëm të ardhura për ta blerë automjetin, pasi ka pasur të ardhura: *(i)* si invalide paraplegjike në vitin 2010, në shumën 255.770 lekë, provuar me shkresën nr. {***} prot., datë 18.9.2024, të Njësisë Administrative {***}; *(ii)* në formën e pensionit të pleqërisë, provuar me shkresën nr. {***} prot., datë 20.9.2024, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Gjirokastër; *(iii)* nga puna bujqësore si banore e Komunës {***}; si dhe *(iv)* në formë dhurate nga 7 fëmijët e saj.
87. Për më tepër, subjekti pretendon se, sipas analizës financiare të Komisionit, rezultati financiar për vitin 2010 ka qenë pozitiv dhe disa herë më i lartë se vlera e automjetit, çka dëshmon se ai kishte vetë mundësi financiare për ta blerë atë. Subjekti ka sqaruar gjithashtu se e ka shoqëruar nënën e tij për kryerjen e vizitave dhe kontrolleve mjekësore rreth 5-6 herë në vit dhe se shpenzimet për karburantin janë përballuar prej tij. Ai pretendon se nuk ka përfituar në mënyrë të padrejtë nga statusi i nënës së tij, pasi automjeti është blerë prej kësaj të fundit në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërsa qëllimi i këtij legjislacioni është pikërisht t'u mundësojë familjarëve ose të afërmve të drejtojnë automjetin për shoqërimin dhe përmbushjen e nevojave të personave që gëzojnë këtë status. Në këtë kuadër, subjekti ka shpjeguar se ka qenë i vetmi fëmijë që mund të drejtonte automjetin në shërbim të nënës së tij. Në përfundim, subjekti pretendon se, nëpërmjet fakteve dhe provave të paraqitura, ka arritur të japë shpjegime të mjaftueshme dhe të përmbysë barrën e provës lidhur me pasurinë “automjet” në përdorim.
88. Bazuar në situatën e mësipërme faktike, trupi gjykues vlerëson se veprimet juridike që lidhen me blerjen dhe përdorimin e automjetit, si dhe përfitimi i lehtësive tatimore dhe doganore në lidhje me importimin e tij, rezultojnë të jenë kryer në përputhje me ligjin nr. 8626/2000 dhe aktet nënligjore përkatëse. Automjeti është regjistruar në pronësi të nënës së subjektit, përfituese e statusit të invaliditetit paraplegjik, ndërsa përdorimi i tij nga subjekti është formalizuar me deklaratën noteriale të vitit 2010, pra përpara fillimit të procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, përdorimi i automjetit është deklaruar nga subjekti në deklaratën

vetting dhe është konfirmuar prej tij gjatë hetimit administrativ. Këto rrethana nuk mbështesin përfundimin e Komisionit se subjekti ka ndërmarrë veprime për të paraqitur ndryshe situatën faktike apo për të fshehur përdorimin e automjetit, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Përkundrazi, deklarimi i përdorimit të automjetit nga vetë subjekti, në kuadër të procesit të rivlerësimit, përbën një element transparence, i cili bie ndesh me hipotezën e një qëllimi për fshehjen e kësaj rrethane.

89. Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, rezultoi e provuar se nëna e subjektit gëzonte statusin e invalides paraplegjike të grupit të parë dhe përfitonte të ardhura të ligjshme nga pensioni i invaliditetit dhe pensioni i pleqërisë, të cilat, në kushtet kur ajo jetonte së bashku me vëllain e subjektit të rivlerësimit, ishin të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e automjetit. Nga ana tjetër, edhe analiza financiare e subjektit për vitin 2010 rezultoi me balancë pozitive dhe me burime të ligjshme disa herë më të larta se vlera e automjetit. Në këto kushte, mungon një logjikë ekonomike e besueshme që blerja e automjetit në emër të nënës të interpretohet si një mekanizëm për fshehjen e një pasurie të subjektit apo si një përpjekje për të paraqitur ndryshe situatën faktike për shkak të mungesës së burimeve financiare për blerjen e tij.
90. Po kështu, përdorimi i automjetit nga subjekti i rivlerësimit, në funksion të transportit dhe shoqërimit të nënës invalide për kryerjen e vizitave dhe kontrolleve mjekësore, është në përputhje me qëllimin e legjislacionit që parashikon lehtësira për personat me aftësi të kufizuara dhe realizimin e mbështetjes sociale, në kuptim të nenit 59 të Kushtetutës. Nga aktet në dosje, nuk rezultoi asnjë element që të tregojë përdorim fiktiv të statusit të invaliditetit apo përfitim të padrejtë nga ana e nënës së subjektit, ndërsa dyshimet e ngritura nga Komisioni mbështeten vetëm në mënyrën e përdorimit të automjetit nga subjekti dhe jo në prova konkrete që të dëshmojnë përfitimin e lehtësive në rrethana fiktive ose në shmangie të qëllimshme të ligjit. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se jo çdo sjellje që mund të ngrejë dyshime ose të perceptohet si e diskutueshme është, në vetvete, e mjaftueshme për të mbështetur përfundimin se është cenuar besimi i publikut te sistemi i drejtësisë. Për të arritur në një përfundim të tillë, kërkohet që rrethanat e konstatuara të jenë objektivist të përshtatshme, të mbështetura në prova dhe mjaftueshëm domethënëse për të vënë në pikëpyetje standardet e etikës dhe integritetit që kërkohen nga një magjistrat. Në mungesë të këtyre elementeve, rrethanat e konstatuara në këtë rast, nuk mund të merren në konsideratë si bazë për një vlerësim negativ të subjektit në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të tri kritereve të rivlerësimit.
91. Për sa u arsyetua më sipër, trupi gjykues vlerëson se, lidhur me pasurinë në përdorim automjet “Mercedes Benz”, nuk u konstatuan rrethana faktike të tilla që të përbënin sjellje të subjektit të rivlerësimit që cenonjë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

➤ *Lidhur me procedimin penal nr. {***}/2015:*

92. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim konkluzionin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime hetimore ezauruese për të provuar shkeljet e konstatuara,*

të cilat kanë dëmtuar shëndetin e shtetasit B. Rr.

93. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se, në rastin konkret, nuk ekzistonin elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Sipas tij, referuar nenit 184, pika 2, shkronja “d” e Kodit Rrugor, drejtuesi i mjetit konsiderohet në gjendje të dehur vetëm kur niveli i alkoolit i konstatuar nga testi përkatës, rezulton mbi kufirin ligjor prej 0,5 gramë/litër. Në kushtet kur testi i alkoolit i kryer ndaj shtetasit N. Ll. ka rezultuar në nivelin 0,3 gramë/litër, subjekti pretendon se ndodhemi përpara një kundërvajtjeje administrative dhe jo një vepre penale. Të njëjtat shpjegime subjekti i ka paraqitur edhe në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ.
94. Trupi gjykues, në shqyrtim të pretendimeve të mësipërme dhe pas verifikimit të akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, konstaton dhe vlerëson si në vijim.
95. Mbi bazën e referimit të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Vlorë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 30.06.2015, për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290, paragrafi i dytë i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit N. Ll. Nga analizimi i aktit “Informacion për referim të veprës penale”, datë 30.06.2015, rezulton se, më datë 29.06.2015, rreth orës 22:50, është arrestuar në flagrancë shtetasi N. Ll., i cili, duke drejtuar automjetin e markës “Mercedes Benz”, me targë {***}, ka aksidentuar shtetasin B. Rr., i cili drejtonte motomjetin e markës “Suzuki”, me targë {***}. Si pasojë e përplasjes së dy mjeteve, shtetasi B. Rr. ka pësuar dëmtime dhe është transportuar në Spitalin Rajonal të Vlorës për të marrë asistencën e nevojshme mjekësore.
96. Pasi janë kryer veprimet e para hetimore nga oficeri i policisë gjyqësore (në vijim “OPGj”), në funksion të arrestit në flagrancë, subjekti i rivlerësimit ka proceduar, brenda afatit ligjor, me vleftësimin e ligjshëm të kontrollit personal, duke i kërkuar gjykatës vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë për shtetasin N. Ll., si dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Në vijim, subjekti ka proceduar edhe me vleftësimin e veprimeve të tjera hetimore të kryera nga OPGj-ja. Për ekzaminimin e dëmtimeve të të dëmtuarit, është caktuar eksperti, i cili, me aktin e ekspertimit mjeko-ligjor nr. {***}, datë 01.07.2015, ka konkluduar se tek i dëmtuari konstatohen plagë në kokë dhe thyerje e kockës së shpatullës, të cilat klasifikohen në kategorinë e dëmtimeve që sjellin paaftësi të përkohshme në punë mbi 9 (nëntë) ditë. Mbi bazën e këtij akti dhe pas përfundimit të veprimeve hetimore, subjekti, më datë 03.09.2015, ka vendosur pushimin e çështjes penale, me arsyetimin se vepra penale nuk ekziston, pasi dëmtimet e konstatuara kishin sjellë paaftësi të përkohshme për punë dhe nuk përbënin pasojat penale të kërkuara nga ligji për ekzistencën e veprës penale përkatëse.
97. Referuar akteve të fashikullit hetimor, Komisioni ka konstatuar se në aktin “Formular i verifikimit të përdorimit të pjesë alkoolike”, lëshuar nga Komisarati i Policisë Vlorë, citohet se: “drejtuesit të mjetit iu bë testi i alkoolit me gyp qelqi nga ana e frymëmarrjes dhe rezulton se drejtuesi ka përdorur alkool deri në 0,3%”, për të cilin vetë drejtuesi i mjetit ka deklaruar se është dakord. Në këto kushte, Komisioni i kërkoj subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me administrimin e këtij akti dhe vlerësimin prej tij të rezultatit të testit të alkoolit, nëse

rezultonte e nevojshme kryerja e veprimeve të mëtejshme hetimore për zbardhjen e fakteve penale, duke përfshirë edhe vlerësimin në drejtim të veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

98. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ, subjekti ka sqaruar se, në rastin konkret, nuk ekzistonin elementet e veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, pasi, sipas nenit 184, pika 2, shkronja “d” e Kodit Rrugor, drejtuesi i mjetit konsiderohet në gjendje të dehur vetëm kur niveli i alkoolit i konstatuar nga testi përkatës rezulton mbi kufirin ligjor prej 0,5 gramë/litër, ndërkohë që niveli i alkoolit i konstatuar ndaj shtetasit N. Ll. ka qenë 0,3 gramë/litër.
99. Në vlerësim të trupit gjykues, konstatimi i Komisionit nuk gjen mbështetje as në situatën faktike të provuar nga aktet e fashikullit penal dhe as në elementet përbërëse të veprës penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Referuar aktit “Formular i verifikimit të përdorimit të pijes alkoolike”, niveli i alkoolit i konstatuar ndaj drejtuesit të mjetit ka qenë 0,3 gramë/litër, pra nën kufirin ligjor prej 0,5 gramë/litër, të përcaktuar në nenin 184, pika 2, shkronja “d” e Kodit Rrugor. Në këto kushte, mungonte elementi objektiv që do të mund të orientonte ekzistencën e dyshimeve për konsumimin e veprës penale të “Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se nuk ekzistonin të dhëna faktike apo juridike që të impononin kryerjen e veprimeve të tjera hetimore nga ana e subjektit në drejtim të këtij kualifikimi juridik. Detyrimi i prokurorit për kryerjen e veprimeve hetimore shtesë nuk mund të mbështetet në hipoteza abstrakte apo dyshime të papërcaktuara, por duhet të bazohet në ekzistencën e të dhënave konkrete faktike ose juridike që krijojnë një dyshim të arsyeshëm për ekzistencën e një vepre penale. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit në këtë aspekt, gjenden të bazuara dhe konkluzioni i Komisionit nuk qëndron.

➤ *Lidhur me procedimin penal nr. {***}/2016:*

100. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankimin e tij vlerësimin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet hetimore ezauruese për të provuar shkeljet e pretenduara nga ana e shtetasit M. V., lidhur me veprimet e punonjësve të policisë, si dhe nuk ka arsyetuar në vendimin e marrë, pretendimin e ngritur prej tij.*
101. Në shkaqet e ankimit, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar në fakt dhe në ligj, si dhe i paarsyetuar, pasi nuk evidenton ndonjë dispozitë konkrete ligjore apo rregull procedural të shkelur prej tij në ushtrimin e funksionit të prokurorit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016. Sipas subjektit, nga tërësia e akteve procedurale të administruara në fashikullin hetimor, nuk rezulton asnjë e dhënë tjetër që të mbështesë pretendimin e ngritur nga shtetasi M. V. se ndërhyrja e tij ishte pasojë e sjelljes së punonjësve të policisë ndaj vëllait të tij të mitur. Po kështu, personat e tjerë të pyetur, lidhur me rrethanat e ngjarjes, nuk kanë evidentuar në asnjë moment praninë e vëllait të mitur të këtij shtetasi në vendngjarje apo përfshirjen e tij në konflikt. Për këtë arsye, subjekti pretendon se deklaratimet e M. V. kishin karakter tërësisht mbrojtës dhe justifikues dhe nuk impononin kryerjen e verifikimeve të mëtejshme hetimore.

102. Trupi gjykues, në shqyrtim të pretendimeve të mësipërme dhe pas verifikimit të akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, konstaton dhe vlerëson si në vijim.
103. Mbi bazën e kallëzimit të datës 16.05.2016, të paraqitur nga shtetasja S. S., me detyrë inspektore e policisë së rendit, subjekti i rivlerësimit, me urdhrin e datës 18.05.2016, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuar nga neni 236/1 i Kodit Penal, ndaj shtetasit M. V. Kallëzuesja ka pretenduar se, gjatë ushtrimit të detyrës për dokumentimin e rrethanave të një konflikti të ndodhur në një banesë në qytetin e Vlorës, është shtyrë dhe goditur nga shtetasi M. V.
104. Referuar akteve të fashikullit penal, rezulton se më datë 16.05.2016, policia gjyqësore është njoftuar për një konflikt midis dy familjeve në lagjen “{***}”, Vlorë. Nga veprimet e para hetimore, është konstatuar se konflikti kishte lindur për shkak të prishjes së një muri ndarës ndërmjet banesave. Në grupin e punës të policisë, të pranishëm në vendngjarje ndodheshin kallëzuesja dhe dy punonjës të tjerë të policisë, të cilët, ndërsa po sqaronin rrethanat dhe motivet e konfliktit, janë përballur me ndërhyrjen e shtetasit M. V., i cili ka tentuar të hyjë në banesën e xhaxhait të tij, N. V., personit që kishte njoftuar policinë për konfliktin.
105. Sipas deklarimeve të kallëzueses, ajo i ka bërë të ditur shtetasit M. V. se nuk mund të hynte në banesë për shkak se në vendngjarje po kryheshin ende veprime procedurale dhe se duhej të largohej. Megjithatë, ky i fundit nuk i është bindur kërkesës së saj dhe është shprehur se: “[...] nuk keni punë në banesën e xhaxhait tim [...]”, duke përdorur njëkohësisht fjalor fyes. Në momentin kur kallëzuesja ka tentuar ta pengojë të hynte në banesë, M. V. e ka shtyrë dhe goditur me shkelm, duke tentuar më pas të largohej me vrap në drejtim të banesës së tij. Në këto rrethana, punonjësit e tjerë të policisë kanë ndërhyrë, duke e ndaluar dhe shoqëruar në automjetin e policisë.
106. Pasi ka marrë në pyetje, në cilësinë e dëshmitarëve, dy punonjësit e tjerë të policisë të pranishëm në vendngjarje, të cilët kanë konfirmuar rrethanat e referuara nga kallëzuesja, si dhe vetë personin nën hetim, subjekti i rivlerësimit, më datë 20.05.2016, ka paraqitur kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal ndaj M. V. për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”. Me vendimin nr. {***}, datë 12.12.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka deklaruar fajtor M. V. për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, sipas nenit 236/1 të Kodit Penal, duke e dënuar me 50.000 lekë gjobë.
107. Komisioni ka konstatuar se, në procesverbalin e marrjes së të dhënave nga personi për të cilin zhvilloheshin hetimet, M. V. ka deklaruar se ndërhyrja e tij ndaj forcave të policisë kishte ardhur pasi kishte parë punonjësit e policisë duke kapur nga shpatullat dhe duke shtyrë vëllain e tij të mitur. Nisur nga ky deklaram, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit duhej të kishte kryer veprime të tjera verifikuese dhe hetimore për sqarimin e kësaj rrethane dhe i ka kërkuar shpjegime lidhur me këtë aspekt.
108. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ dhe në shkaqet e ankimit, subjekti ka shpjeguar se deklarimi i M. V. nuk mbështetet nga asnjë provë tjetër e administruar në fashikullin penal. Sipas tij, asnjë nga personat e pyetur lidhur me rrethanat e ngjarjes nuk ka

evidentuar praninë e vëllait të mitur të M. V. në vendngjarje apo përfshirjen e tij në konflikt. Subjekti ka theksuar gjithashtu se deklaratimet e M. V. kanë qenë kontradiktore dhe të orientuara drejt justifikimit të sjelljes së tij ndaj punonjësve të policisë.

109. Nga procesverbali i datës 20.05.2016, për marrjen e të dhënave nga personi për të cilin zhvilloheshin hetimet, rezulton se M. V. është shprehur se: *Kam parë forcat e policisë [...] kanë vazhduar duke kapur vëllain tim të vogël nga shpatullat dhe duke e shtyrë. Në këtë çast, kam ndërhyrë pasi nuk e shikoja dot vëllain tim kur e shtynin në atë mënyrë [...] nuk kam goditur unë asnjë njeri dhe aq më tepër një femër, por vetëm kam ndërhyrë për të mos ma shtyrë vëllain [...].*
110. Në vlerësim të trupit gjykues, deklaratimet e mësipërme të personit nën hetim kanë karakter mbrojtës dhe justifikues në raport me sjelljen e tij ndaj forcave të policisë. Këto deklarime nuk parashtrojnë fakte konkrete, të verifikueshme dhe potencialisht të rëndësishme për objektin e procedimit penal, të cilat të krijojnë nevojën për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore nga ana e subjektit të rivlerësimit. Detyrimi i prokurorit për të zgjeruar hetimin nuk mund të mbështetet vetëm në pretendime të njëanshme të personit nën hetim, por kërkon ekzistencën e elementeve objektive që krijojnë dyshime të arsyeshme për nevojën e verifikimeve shtesë.
111. Për më tepër, Komisioni nuk ka individualizuar se cilat ishin konkretisht veprimet hetimore të pakryera apo cilat rrethana me rëndësi për procedimin penal duhej të verifikoheshin nga subjekti në kuadër të këtij procedimi penal. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se nuk provohet ndonjë mangësi në veprimtarinë hetimore të subjektit apo cenim i të drejtave procedurale të personave të përfshirë në procedim. Ky përfundim përforcohet edhe nga fakti se procedimi penal ka përfunduar me deklaratimin fajtor të të pandehurit M. V. për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, me vendimin nr. {***}, datë 12.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, vendim i cili ka marrë formë të prerë. Për rrjedhojë, trupi gjykues i gjen të bazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit në këtë aspekt.
- *Lidhur me procedimin penal nr. {***}/2016:*
112. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar vlerësimin e Komisionit se *subjekti i rivlerësimit ka kërkuar masën e sigurimit në kushtet e flagrancës në përputhje me nenin 252 të Kodit të Procedurës Penale, i cili është vlerësuar edhe nga gjykata si i ligjshëm. Komisioni çmon se nga ana e subjektit, nuk janë respektuar elementet e një procesi të rregullt ligjor, duke i mohuar personit në hetim të drejtën për të marrë avokat, e drejtë kjo e cila rezulton të mos i jetë shpjeguar personit të arrestuar në kushtet e flagrancës.*
113. Në shkaqet e ankimit, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është tërësisht i pabazuar dhe i paarsyetuar, duke krijuar përshtypjen se synon të justifikojë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Sipas subjektit, arrestimi në flagrancë është kryer nga policia gjyqësore dhe, referuar nenit 252 të Kodit të Procedurës Penale, prania e mbrojtësit nuk përbën kusht ligjor për vlefshmërinë e këtij veprimi procedural.
114. Trupi gjykues, në shqyrtim të pretendimeve të mësipërme dhe pas verifikimit të akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, konstaton dhe vlerëson si në vijim.

115. Nga aktet e fashikullit hetimor, rezulton se më datë 15.04.2016, shtetasi A. N., student në Universitetin “{***}” të Vlorës, ka paraqitur kallëzim penal ndaj shtetasit E. K., duke pretenduar se ky i fundit i kishte vjedhur një bluzë dhe biçikletën personale nga dhoma e konviktit, ngjarje e ndodhur më datë 23.02.2016. Po në datën 15.04.2016, rreth orës 02:45, policia gjyqësore ka arrestuar në flagrancë shtetasin E. K. si të dyshuar për kryerjen e veprës penale.
116. Në vlerësim të të dhënave të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur marrjen si të pandehur të shtetasit E. K. për veprën penale të “Vjedhjes”, të parashikuar nga neni 134, paragrafi i parë i Kodit Penal, duke i njoftuar njëkohësisht akuzën përkatëse.
117. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në gjykatë kërkesën për gjykim, duke kërkuar deklarinim fajtor të të pandehurit E. K. për veprën penale “Vjedhja”, të parashikuar nga neni 134, paragrafi i parë i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë gjobë.
118. Me vendimin nr. {***}, datë 17.04.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: (i) deklarinim fajtor të të pandehurit E. K. për kryerjen e veprës penale “Vjedhja”, të parashikuar nga neni 134, paragrafi i parë i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 150.000 lekë gjobë; si dhe (ii) në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit dhe dënimin përfundimtar të tij me 100.000 lekë gjobë.
119. Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime lidhur me konstatimet se: (i) nga analiza e akteve nuk rezultonin kushtet e gjendjes së flagrancës për arrestimin e shtetasit E. K., pasi ngjarja e kallëzuar kishte ndodhur disa javë përpara arrestimit; dhe (ii) arrestimi i kryer në orën 02:45 nuk justifikonte një urgjencë të tillë që të kufizonte mundësinë efektive të të arrestuarit për të zgjedhur një mbrojtës, duke ngritur dyshime për cenimin e së drejtës së mbrojtjes.
120. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ, subjekti ka sqaruar se, referuar nenit 252 të Kodit të Procedurës Penale, gjendja e flagrancës ekziston edhe kur personi kapet me sende ose prova materiale nga të cilat duket se ka kryer veprën penale. Në rastin konkret, shtetasi E. K. është kapur me bluzën e veshur, e cila ishte identifikuar nga kallëzuesi si send i vjedhur prej tij. Subjekti ka theksuar gjithashtu se ligjshmëria e arrestimit në flagrancë është vlerësuar nga gjykata dhe se i arrestuari nuk ka ngritur në asnjë moment pretendime lidhur me cenimin e së drejtës së mbrojtjes. Përkundrazi, edhe gjatë marrjes në pyetje si i pandehur, ai nuk ka kërkuar asistencën e një mbrojtësi.
121. Sa i përket konstatimit të Komisionit mbi mungesën e kushteve të flagrancës, trupi gjykues vëren se ky përfundim nuk mbështetet në aktet e procedimit penal. Referuar nenit 252 të Kodit të Procedurës Penale, gjendja e flagrancës nuk kufizohet vetëm në rastet kur personi kapet në çastin e kryerjes së veprës penale, por përfshin edhe rastet kur ai kapet me sende ose prova materiale nga të cilat duket se ka kryer veprën penale. Në kushtet kur shtetasi E. K. është konstatuar në posedim të një sendi të identifikuar nga kallëzuesi si objekt i vjedhjes, nuk rezulton se subjekti ka vepruar në kundërshtim me kuadrin procedural penal. Po kështu, vetë fakti që gjykata ka proceduar me gjykimin e çështjes dhe ka deklaruar fajtor të pandehurin për veprën penale të vjedhjes përforcon përfundimin se nuk evidentohet ndonjë shkelje

procedurale e tillë që të vërë në pikëpyetje ligjshmërinë e veprimeve të ndërmarra nga subjekti.

122. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes, trupi gjykues vëren se ky konstatim nuk mbështetet në aktet e administruara në fashikullin e procedimit penal nr. {***}/2016. Referuar procesverbalit të arrestimit në flagrancë, rezulton se oficeri i policisë gjyqësore, në përputhje me nenin 255 të Kodit të Procedurës Penale, i ka bërë të ditur shtetasit E. K. të drejtat procedurale, përfshirë të drejtën për të mos bërë deklaramë, të drejtën që çdo deklaramë i tij mund të përdoret si provë në gjykim, si dhe të drejtën për të pasur mbrojtës. Megjithatë në procesverbalin e nënshkruar nga i arrestuari dhe OPGj-ja nuk rezulton që ai të ketë shprehur zgjedhjen e tij lidhur me mënyrën e mbrojtjes, kjo rrethanë nuk nënkupton, në vetvete, mohimin e së drejtës për mbrojtje. Për më tepër, i arrestuari nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur me arrestimin apo respektimin e të drejtave të tij procedurale, duke pranuar fajësinë dhe duke shfaqur pendesë për ngjarjen e ndodhur. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se nuk evidentohen elemente konkrete që të provojnë cenimin e procesit të rregullt ligjor apo mangësi në veprimtarinë procedurale të subjektit të rivlerësimit, ndaj konkluzionet e Komisionit në këtë drejtim rezultojnë të pambështetura në fakte dhe në aktet e procedimit penal.

➤ *Lidhur me gjetjet e konstatuara gjatë periudhës së ushtrimit nga subjekti i rivlerësimit të detyrës si Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat:*

123. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim konkluzionin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës së ushtrimit nga subjekti të detyrës si Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, nuk ka ushtruar në mënyrë të plotë dhe ezauruese kompetencat e tij, bazuar në urdhrin nr. 147, datë 9.5.2008, "Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë", të Prokurorit të Përgjithshëm, pika 3, të cilat nuk kanë pasur të bëjnë në atë kohë vetëm me siglimin e kërkesës për gjyq.*

124. Në shkaqet e ankimit, subjekti i rivlerësimit pretendon se edhe në këtë rast, nuk është e qartë se cilën kompetencë konkrete ai nuk ka ushtruar dhe cilin nga indikatorët e vlerësimit profesional, të përcaktuar nga ligji nr. 96/2016, ka cenuar. Sipas subjektit, konkluzioni i Komisionit është i paarsyetuar dhe i pambështetur në prova, duke përbërë një tjetër tregues të mungesës së paanshmërisë në vlerësimin e veprimtarisë së tij profesionale.

125. Trupi gjykues, në shqyrtim të pretendimeve të mësipërme dhe pas verifikimit të akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, konstaton dhe vlerëson si vijon.

126. Referuar të dhënave të pasqyruara në raportin për vlerësimin e aftësive profesionale, të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, rezulton se në rubrikën e të dhënave arkivore, është trajtuar edhe ankesa nr. {***} e vitit 2010, e paraqitur nga shtetasi A. V. dhe e përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme, nëpërmjet Drejtorisë Gjyqësore.

127. Shtetasi A. V. ka ngritur pretendime për veprime në kundërshtim me ligjin nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, z. Xhemal Saliaj, si dhe prokurorit K.B., në lidhje me hetimin dhe dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. {***}/2007, në të cilin ai kishte qenë në cilësinë e të pandehurit. Ankuesi pretendonte se ishte

marrë padrejtësisht i pandehur dhe se, me vendimin nr. {***}, datë 03.12.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, lënë në fuqi me vendimin nr. {***} datë 27.01.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë, procedimi penal ndaj tij ishte pushuar. Në këtë kuadër, ai kishte paraqitur ankesë edhe ndaj subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë.

128. Nga aktet e administruara nga Komisioni, rezulton se procedimi penal nr. {***}/2007, i regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, është zhvilluar ndaj shtetasit A. V. për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, për shkak të funksionit të tij si shef i seksionit të krimeve në Komisaratin e Policisë Skrapar. Kjo çështje nuk është hetuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, por nga një prokuror tjetër i kësaj prokurorie, ndërkohë që subjekti ushtronte funksionin e drejtuesit të saj. Rezulton gjithashtu se procedimi penal është dërguar për gjykim për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”.
129. Me vendimin nr. {***}, datë 03.12.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur pushimin e gjyqimit të çështjes, me arsyetimin se procedimi penal nuk duhej të kishte filluar për shkak të mungesës së elementeve të figurës së veprës penale. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 27.01.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë.
130. Komisioni ka konstatuar se, bazuar në urdhrin nr. 147, datë 09.05.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”, drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë kanë detyrimin të kontrollojnë bazueshmërinë ligjore të akteve procedurale që dërgohen në gjykatë dhe mbajnë përgjegjësi për kontrollin e zgjidhjes ligjore dhe formulimin e akteve nga prokurorët më të ulët.
131. Nisur nga ky konstatim, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë shpjegime dhe të dokumentojë mënyrën e ushtrimit të kontrollit të tij si drejtues i prokurorisë në këtë procedim penal.
132. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar dinamikën e çështjes dhe ka pretenduar se ka ushtruar në mënyrë të plotë kompetencat e tij drejtuese, duke paraqitur si provë vendimin “Për dërgimin e çështjes në gjyq”, datë 11.09.2008, të sigluar prej tij në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë.
133. Trupi gjykues vëren se konkluzioni i Komisionit nuk përmban një analizë konkrete mbi mënyrën se si subjekti ka dështuar në ushtrimin e kompetencave të tij drejtuese, si dhe nuk individualizon veprimet apo mosveprimet specifike që ai duhej të kishte kryer në kuadër të kontrollit të procedimit penal në fjalë. Në mungesë të një analize të tillë dhe të identifikimit të shkeljeve konkrete, përfundimi i Komisionit rezulton i paarsyetuar dhe i pambështetur në prova.
134. Referuar përmbajtjes së urdhrit nr. 147, datë 09.05.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, rezulton se pika 2.1 e tij parashikonte detyrimin e prokurorit të çështjes për të diskutuar paraprakisht me drejtuesin e prokurorisë, ndër të tjera, kërkimet në konkluzionet përfundimtare për deklarimin e fajësisë dhe caktimin e llojit dhe masës së dënimit, me qëllim parandalimin e vendimmarrjeve të pabazuara në ligj dhe në prova. Për këto akte, kur binte dakord, drejtuesi i prokurorisë vendoste nënshkrimin e tij në thembër të aktit, kopje e të cilit administrohej në fashikullin përkatës.

135. Në rastin konkret, subjekti ka shpjeguar se kontrolli i kërkuar nga urdhri nr. 147/2008 është ushtruar nëpërmjet siglimit të vendimit “Për dërgimin e çështjes në gjyq”, datë 11.09.2008, akt i cili është paraqitur prej tij edhe në cilësinë e provës. Në vlerësim të trupit gjykues, siglimi i këtij akti nga drejtuesi i prokurorisë përbën shprehje të ushtrimit të kompetencës së kontrollit dhe të dakordësisë së tij lidhur me vijimin e procedimit penal, në përputhje me kërkesat e pikës 2.1 të urdhrin nr. 147/2008. Për rrjedhojë, në mungesë të elementeve konkrete që të provojnë ushtrimin e mangët ose formal të kësaj kompetence, trupi gjykues çmon se shkak i ankimit në këtë aspekt, gjendet i bazuar.

➤ *Lidhur me gjetjet e raportit të auditimit të Prokurorisë së Përgjithshme në vitin 2012:*

136. Subjekti i rivlerësimit kundërshton në ankim vlerësimin e Komisionit se: *shkeljet e konstatuara nga grupi i kontrollit të auditit, nuk kanë qenë objekt i rishikimit gjyqësor dhe, për pasojë, janë konstatuar si të tilla gjatë ushtrimit të detyrës së subjektit si Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat. Këto shkelje, Komisioni i ka vlerësuar në raport me gjetjet e tjera gjatë procesit të rivlerësimit, duke i marrë në konsideratë në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*

137. Subjekti pretendon se ky konkluzion është në kundërshtim me provat e administruara dhe me vendimet gjyqësore të paraqitura prej tij. Sipas subjektit, bazuar në raportin e auditit, Prokuroria e Përgjithshme ka ngritur padi për kthimin e shumës 930.457 lekë, duke pretenduar se kjo shumë përbënte dëm ekonomik të shkaktuar prej tij. Megjithatë, gjykatat kanë arritur në përfundimin se shkeljet e pretenduara dhe dëmi i pretenduar nuk u provuan, ndërsa këto vendime kanë marrë formë të prerë. Për rrjedhojë, sipas subjektit, konkluzioni i Komisionit jo vetëm është i pavërtetë, por bie ndesh edhe me parimet e shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike.

138. Trupi gjykues, në shqyrtim të pretendimeve të mësipërme dhe pas verifikimit të akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, konstaton dhe vlerëson si vijon.

139. Nga auditimi i ushtruar nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Prokurorisë së Përgjithshme, bazuar në urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm, datë 28.06.2012, mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat për periudhën 2011-2012, është konkluduar se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të kësaj prokurorie, kishte kryer shkelje në lidhje me shpenzimet e transportit, duke përdorur automjetin e institucionit dhe njëkohësisht duke përfituar bonus transporti sipas ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009, me pasojë pretendimin për një dëm ekonomik në shumën 930.457 lekë.

140. Bazuar në këtë raport, Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar hartimin e një plani veprimi për arkëtimin e shumës së pretenduar si dëm, ndërsa Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat ka nxjerrë urdhrin nr. {***}, datë 29.10.2012, për mbajtjen nga paga e subjektit të shumës 15.000 lekë në muaj deri në shlyerjen e plotë të saj.

141. Duke mos qenë dakord me këto akte, subjekti i rivlerësimit i ka kundërshtuar ato në rrugë gjyqësore. Me vendimin nr. {***}, datë 28.12.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, anulimin e ndalesave nga paga e paditësit dhe

detyrimin e të paditurve për kthimin e shumave të mbajtura, vendim i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 07.05.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

142. Komisioni ka vlerësuar se këto vendime nuk kanë shqyrtuar në themel ekzistencën ose jo të shkeljeve të konstatuara në raportin e auditit, por janë ndalur vetëm në natyrën juridike të akteve administrative të nxjerra për ekzekutimin e shumës së pretenduar si dëm.
143. Nga aktet e administruara, rezulton se, pas anulimit të akteve administrative të mbajtjes nga paga, Prokuroria e Përgjithshme i është drejtuar më pas Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me padi në themel, duke kërkuar detyrimin e subjektit për kthimin e shumës 930.457 lekë, mbi bazën e gjetjeve të raportit të auditimit dhe pretendimit për shkelje të ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009.
144. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ, subjekti ka theksuar se vendimet e gjykatave administrative kanë shqyrtuar në themel pretendimet e ngritura nga Prokuroria e Përgjithshme dhe kanë arritur në përfundimin se ai nuk kishte kryer shkelje ligjore. Në mbështetje të këtij pretendimi, ai ka paraqitur në cilësinë e provës praktikën gjyqësore të krijuar në lidhje me këtë çështje.
145. Nga përmbajtja e vendimit nr. {***}, datë 07.02.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, rezulton se kjo gjykatë ka shqyrtuar në themel pretendimet e ngritura nga Prokuroria e Përgjithshme dhe ka arritur në përfundimin se raporti i auditimit ishte i kundërligjshëm, se nuk ishte provuar ekzistenca e dëmit të pretenduar, se nuk ekzistonte lidhje shkakësore ndërmjet veprimeve të subjektit dhe dëmit të pretenduar, si dhe se nuk rezultonte shkelje e ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. {***}, datë 12.05.2014, ka lënë në fuqi këtë vendim, duke arsyetuar se nuk ishte provuar që subjekti të kishte përdorur automjetet e institucionit në kundërshtim me ligjin, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. {***}, datë 08.02.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm.
146. Në këto kushte, trupi gjykues vëren se konkluzioni i Komisionit, sipas të cilit gjetjet e auditit nuk kanë qenë objekt i rishikimit gjyqësor, nuk gjen mbështetje në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ dhe në përmbajtjen e vendimeve gjyqësore të administruara në dosje.
147. Nga analiza e këtyre vendimeve, rezulton se gjykatat kanë marrë në shqyrtim në themel si pretendimet e ngritura nga Prokuroria e Përgjithshme, ashtu edhe vetë gjetjet e pasqyruara në raportin e auditimit, duke arritur në përfundimin se shkeljet dhe dëmi i pretenduar nuk u provuan. Për rrjedhojë, gjetjet e auditit nuk mund të konsiderohen si rrethana të mirëqena në vlerësimin e veprimtarisë profesionale të subjektit.
148. Trupi gjykues çmon se pretendimet e subjektit lidhur me gjetjet e auditit të vitit 2012, rezultojnë të mbështetura në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ dhe në vendimmarrjet gjyqësore të formës së prerë të paraqitura në cilësinë e provës.
149. Për rrjedhojë, vlerësimi i Komisionit, sipas të cilit këto gjetje duhej të merreshin në konsideratë në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të subjektit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nuk qëndron. Në kushtet kur gjetjet e raportit të auditimit janë bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor në themel dhe janë vlerësuar nga gjykatat si të pabazuara në prova dhe në

ligj, ato nuk mund të përdoren si rrethana negative në vlerësimin e përgjithshëm të subjektit të rivlerësimit.

➤ *Lidhur me gjetjet e konstatuara në denoncimin e shtetasit K. C.:*

150. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e tij në kushtet e konfliktit në dukje të interesit. Pavarësisht vendimmarrjes së drejtuesit të prokurorisë, në kushtet kur bashkëshortja e subjektit, si pjesë e strukturave vendimmarrëse në universitet, dhe ajo e denoncuesit ishin në një konflikt që ka pasur të bëjë me marrëdhëniet e punës, subjekti duhet të të shmangte nëpërmjet dorëheqjes konfliktin në dukje të interesit. Përveç sa më sipër, mungesa e vendimeve të shtyrjes, si dhe mosregjistrimi në kohë i emrit të personit të cilit i është atribuar vepra penale për 6 vjet, janë marrë në konsideratë nga trupi gjykues në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kritereve sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*
151. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzionet e shumicës vendimmarrëse të Komisionit janë të pabazuara, të paargumentuara dhe të pambështetura në dispozita konkrete ligjore. Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, subjekti ka shpjeguar se kohëzgjatja e hetimeve paraprake është ndikuar nga kalimi i procedimit penal ndërmjet disa prokurorëve, administrimi i letërporosive nga autoritetet italiane, si dhe vonesat në sigurimin e dokumentacionit nga Ministria e Arsimit, e cila nuk iu është përgjigjur në kohë kërkesave të prokurorisë lidhur me vendndodhjen e arkivit të Universitetit “{***}”.
152. Trupi gjykues i Kolegjit, në shqyrtim të pretendimeve të mësipërme, pasi shqyrtoi aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, konstaton dhe vlerëson si vijon.
153. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është regjistruar procedimi penal nr. {***}/2015, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”. Procedimi është trajtuar fillimisht nga subjekti i rivlerësimit, i cili, për shkak të transferimit në seksionin e ekzekutimeve penale, e ka dorëzuar çështjen, për ta rimarrë pas disa vitesh. Denoncuesi ka ngritur pretendime lidhur me mënyrën e caktimit të subjektit si prokuror i çështjes, duke pretenduar se nuk kishte marrë përgjigje nga drejtuesi i prokurorisë dhe duke shprehur dyshime për njëanshmëri për shkak të faktit se bashkëshortja e subjektit ushtronte detyrën e pedagoges pranë Universitetit “{***}”. Denoncuesi ka pretenduar gjithashtu se vepra penale ishte parashkuar, pasi procedimi penal ishte regjistruar në vitin 2015, ndërsa falsifikimi i pretenduar i referohej vitit 2009.
154. Komisioni administroi fashikullin penal²⁴ dhe, nga shqyrtimi i akteve, konstatoi se:
- i) Më datë 20.03.2015 është regjistruar procedimi penal nr. {***}/2015, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit A. Sh. ndaj shtetasit K. Ç. dhe bashkëshortes së tij, të cilët pretendohet se kishin falsifikuar dokumente shkollore.
- (ii) Mbi bazën e kallëzimit të Ministrisë së Arsimit, është regjistruar procedimi penal nr. {***}/2015²⁵, pas publikimeve në portalin “Stop Korrupsionit”, sipas të cilave shtetasi K. Ç.

²⁴ Shkresë nr. {***} prot., datë 19.4.2024, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 24.4.2024.

²⁵ Nga prokurore E. H.

kishte përdorur dokumentacion të falsifikuar për regjistrimin në Universitetin “{***}”.

(iii) Me vendimin e datës 21.09.2016, drejtuesi i prokurorisë ka vendosur bashkimin e procedimeve, duke caktuar si prokuror të çështjes subjektin e rivlerësimit.

155. Komisioni ka konstatuar se procedimi penal ka vijuar për një periudhë të gjatë kohore, nga viti 2015 deri në vitin 2021, kur subjekti procedoi me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq. Sipas Komisionit, veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe kanë qenë sporadike dhe kanë konsistuar kryesisht në kërkesa për informacion drejtuar institucioneve të ndryshme, ndërsa marrja e shtetasit K. Ç. në cilësinë e të pandehurit, është kryer vetëm më datë 26.10.2020.
156. Komisioni ka arsyetuar gjithashtu se nga dosja penale, nuk rezultonte qartë dokumenti konkret që pretendohet të ishte falsifikuar, se provat e administruara nuk mbështesnin ekzistencën e veprës penale të falsifikimit, se subjekti nuk kishte arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme vlerësimin e tij lidhur me akuzën e ngritur, si dhe se nuk kishte marrë në konsideratë pretendimet për mungesë kompetence dhe parashkrim të veprës penale.
157. Komisioni ka vërejtur gjithashtu se denoncuesi kishte paraqitur kërkesa për t’u informuar lidhur me mënyrën e caktimit të subjektit si prokuror i çështjes, duke pretenduar se, për shkak të angazhimit të tij në seksionin e ekzekutimeve penale, procedimi nuk duhej të ndiqej prej tij. Sipas Komisionit, këto kërkesa nuk kishin marrë përgjigje.
158. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni aksesoi edhe burime të hapura, nga të cilat rezultonte se bashkëshortja e denoncuesit ishte larguar nga puna pranë Universitetit të Vlorës dhe se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kishte konstatuar diskriminim ndaj saj. Nisur nga këto rrethana dhe nga fakti se bashkëshortja e subjektit kishte ushtruar funksionin e dekanes në një nga fakultetet e këtij universiteti, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqiste shpjegime dhe prova në lidhje me pretendimet për konflikt interesi.
159. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar se pretendimet e denoncuesit janë të pabazuara në fakte dhe në ligj. Ai ka shpjeguar se është caktuar prokuror i çështjes me vendimin e bashkimit të procedimeve të datës 21.09.2016. Po ashtu, ka sqaruar se kërkesa e K. Ç. për zëvendësimin e tij, është rrëzuar nga drejtuesi i prokurorisë dhe se gjykata ka pushuar gjykimin e ankimit të paraqitur kundër këtij vendimi. Subjekti ka theksuar gjithashtu se pretendimi për parashkrimin e veprës penale është trajtuar dhe është rrëzuar nëpërmjet vendimit të datës 22.01.2021.
160. Në lidhje me pretendimet për mënyrën e caktimit të tij si prokuror, subjekti ka shpjeguar se ndarja në seksione përbën një organizim të brendshëm të prokurorisë dhe nuk përjashton trajtimin e procedimeve të tjera sipas nevojave të institucionit. Për sa i përket pretendimit për konflikt interesi, ai ka sqaruar se bashkëshortja e tij nuk ka qenë pjesë e strukturave që kanë shqyrtuar marrëdhënien e punësimit të bashkëshortes së denoncuesit.
161. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues verifikoi nëse rrethanat e konstatuara nga Komisioni përbëjnë një situatë konflikti interesi, në kuptim të ligjit nr. 9367/2005 dhe të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.

162. Neni 3, pika 4, shkronja “b” e ligjit nr. 9367/2005 përcakton se konflikti në dukje i interesit është gjendja në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken sikur kanë ndikuar ose mund të ndikojnë në ushtrimin e detyrës, ndonëse në fakt një ndikim i tillë nuk ka ndodhur dhe nuk ka mundësi të ndodhë.
163. Në vlerësimin e trupit gjykues, fakti që bashkëshortja e subjektit ka ushtruar funksionin e dekanes pranë Universitetit “{***}”, nuk e lidh automatikisht subjektin me vendimmarrjet që kanë prekur marrëdhënien e punësimit të bashkëshortes së denoncuesit. Kjo rrethanë nuk përfshihet në rastet e parashikuara nga nenet 15 dhe 16 të Kodit të Procedurës Penale dhe nuk krijon në vetvete, një perceptim objektiv dhe të arsyeshëm të njëanshmërisë.
164. Nga aktet e administruara, nuk rezulton e provuar që bashkëshortja e subjektit të ketë marrë pjesë në vendimmarrjen për largimin nga puna të bashkëshortes së denoncuesit. Për rrjedhojë, ushtrimi i funksionit të dekanes dhe pjesëmarrja në struktura universitare nuk mjaftojnë për të imponuar heqjen dorë të subjektit nga procedimi penal nr. {***}/2015.
165. Për më tepër, nga fashikulli penal rezulton se denoncuesi K. C. ka kërkuar zëvendësimin e subjektit për shkaqe që lidhen me pretendime për sjellje të kundërligjshme gjatë hetimit të kallëzimit penal të bërë ndaj tij, por në asnjë rast nuk ka ngritur pretendime për konflikt interesi, të lidhura me marrëdhënien e bashkëshortes së subjektit me universitetin.
166. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ nuk janë të tilla që të krijojnë një situatë konflikti interesi, qoftë edhe në dukje. Për rrjedhojë, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim ligjor për të hequr dorë nga procedimi penal.
167. Sa i takon konkluzionit të Komisionit në lidhje me mosregjistrimin në kohë të emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale, trupi gjykues vëren se neni 287, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale parashikon detyrimin për regjistrimin e emrit të personit në momentin kur ai rezulton nga aktet e procedimit, pa përcaktuar një afat procedural brenda të cilit duhet të kryhet ky regjistrim.
168. Nga kontrolli i veprimtarisë hetimore, rezulton se procedimi penal është shtrirë në një periudhë të gjatë kohore dhe se veprimet hetimore janë kryer me intervale të konsiderueshme kohore. Trupi gjykues vëren se ritmi i ndjekur në zhvillimin e hetimeve, nuk justifikohet plotësisht nga natyra e veprimeve të kryera. Megjithatë, duke marrë në konsideratë ndryshimet e prokurorëve të ngarkuar me procedimin, administrimin e letërporosive dhe vështirësitë në sigurimin e dokumentacionit nga institucionet përkatëse, këto mangësi nuk paraqiten me një shkallë të tillë rëndësie që të justifikojnë një vlerësim negativ përcaktues ndaj subjektit.
169. Sa i takon konkluzionit të Komisionit lidhur me mungesën e vendimeve për zgjatjen e afateve të hetimit, trupi gjykues vëren se Komisioni nuk ka individualizuar konkretisht se cilat vendime mungojnë dhe për cilën periudhë kohore ka lindur nevoja për zgjatje. Nenet 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale parashikojnë afatet e hetimit dhe kushtet për zgjatjen e tyre pas regjistrimit të emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale.

170. Në rastin konkret, rezulton se emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale është regjistruar më datë 22.10.2020, ndërsa më datë 22.01.2021 subjekti ka përpiluar kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, e cila është përcjellë në gjykatë me shkresën e datës 02.02.2021.

171. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq është përpiluar brenda afatit tremujor të parashikuar nga neni 323 i Kodit të Procedurës Penale dhe, për rrjedhojë, nuk ka lindur nevoja për zgjatjen e afatit të hetimeve. Konstatimi i Komisionit në këtë drejtim nuk qëndron.

172. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, trupi gjykues vlerëson se i vetmi aspekt që mund të mbahet në konsideratë në lidhje me këtë denoncim, lidhet me kohëzgjatjen e procedimit penal dhe ritmin jo të njëtrajtshëm të veprimeve hetimore. Megjithatë, këto rrethana, të vlerësuara në kontekstin e veçantë të çështjes, nuk paraqiten me një shkallë të tillë rëndësie që të justifikojnë një vlerësim negativ të subjektit në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të tri kriterëve të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

➤ *Lidhur me vlerësimin mbi cenimin e besimit të publikut:*

173. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se: *konstatimet lidhur me analizimin e aftësive profesionale dhe denoncimet e argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, [...] faktet e vlerësuara dhe të analizuarat më sipër, në këndvështrim të përgjithshëm nuk do të ishin të mjaftueshme për të arritur në një konkluzion negativ lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, por këto fakte, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, cenojnë shkallën e besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit sipas pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

174. Trupi gjykues, bazuar në konkluzionin e arritur më sipër në këtë vendim lidhur me përdorimin e automjetit në pronësi të nënës së subjektit dhe për disa gjetje të Komisionit në vlerësimin e aftësive profesionale, ku e vetmja problematikë e konstatuar lidhej me tejzgjatjen e hetimit në çështjen penale të denoncuesit K.C., vlerëson se konkluzioni i Komisionit se, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë në kuptim të nenit 61, pika 5 e të njëjtë ligj, është i pabazuar në situatën faktike të konstatuar nga gjykimi i çështjes në Kolegj dhe në kuadrin ligjor që normon procesin e rivlerësimit kalimtar.

175. Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Xhemal Saliq ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të nenit 59, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016 dhe, si rrjedhojë, vendimi i Komisionit objekt kontrolli është i pabazuar në fakte e në ligj dhe, për pasojë, duhet të ndryshohet, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Ndryshimin e vendimit nr. 805, datë 07.10.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Xhemal Saliq.

- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 26.01.2026, në Tiranë.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues për shqyrtimin e çështjes nr. 53/2024 (JR), jam kundër vendimit nr. 8, datë 26.01.2026, me të cilin shumica e trupit gjykues vendosi: *Ndryshimin e vendimit nr. 805, datë 07.10.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Xhemal Saliq.*
2. Në analizë të të gjitha akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, shpjegimeve të dhëna nga subjekti në Komision, si dhe pretendimeve të ngritura në Kolegj, bazuar në ligjin e zbatueshëm në këtë proces, në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit Xhemal Saliq nuk rezulton i besueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 e, për pasojë, nuk mund të konfirmohet në detyrë. Ky përfundim vjen si pasojë e deklarimeve të pavërteta të subjektit të rivlerësimit, kryesisht ato që lidhen me huanë e dhënë nga motra, që ka shërbyer për shlyerjen e parakohshme të kredisë financiare në vitin 2009, të shoqëruara me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në vlerë të konsiderueshme për të bërë të zbatueshëm nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

I. Në aspektin procedural

3. Në cilësinë e gjyqtare në pakicë, e gjej të gabuar procedurën e ndjekur nga shumica e trupit gjykues lidhur me dokumentin e lëshuar nga Agjencia Kombëtare Elektronike e Sigurimeve Shoqërore dhe Pensioneve të Greqisë, datë 23.06.2025, që i përket shtetasit J. K., sipas së cilit ky shtetas, *ka përfituar pension për shkak të vdekjes së bashkëshortes për periudhën 01.06.2003–01.03.2007.* Këtë dokument subjekti i rivlerësimit e ka depozituar së bashku me parashtrimet me shkrim të paraqitura në Kolegj, e për pasojë ai nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga neni 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, sipas së cilit, deri pesë ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo prova të reja. Shumica e trupit gjykues, në vlerësimin mbi formën dhe mënyrën e shqyrtimit të çështjes ka çmuar ta trajtojë këtë dokument nën dritën e nenit 49, pika e 3 e ligjit nr. 84/2016, që parashikon se: *“Faktet e njohura për Komisionin ose faktet e njohura botërisht, si dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme”*, duke e konsideruar të panevojshëm administrimin e kësaj prove. Nga ana tjetër, gjatë trajtimit të themelit të çështjes, këtij dokumenti i ka atribuar një efekt kontribues në provimin e nivelit *bindës të ekzistencës së të ardhurave të përfituara nga shtetasi J. K. si pension familjar, për shkak të vdekjes së bashkëshortes së mëparshme, për periudhën 01.06.2003 – 01.03.2007.*
4. Për këtë arsye, shumica e trupit gjykues, në vlerësimin tim, duhej ose të kalonte shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, sipas parashikimit të nenit 51, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, të riçelte hetimi gjyqësor dhe të pranonte dokumentin në cilësinë e provës, apo ta përjashtonte këtë dokument nga analiza e mëtejshme në drejtim të zgjidhjes së çështjes.

II. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

5. Për pasurinë, “apartament banimi me sipërfaqe 71.71 m²”, të ndodhur në Bulevardin “{***}” Vlorë, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, e vlerësoj të drejtë dhe të bazuar konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, pasi ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të kryer pagesën para kohe të kredisë bankare, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pikës 3 e ligjit nr. 84/2016. Nga aktet në dosjen gjyqësore, konstatoj se:

5.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se “*Apartamenti me sipërfaqe 71.71 m²*”, ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë, është blerë sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.04.2004, në vlerën 3.500.000 lekë. Burimi i krijimit është deklaruar kredia nga ProCredit Bank, me vlerë 35.000 euro, dhënë sipas kontratës së huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.05.2004, me kolateral apartamentin objekt vlerësimi.

5.2. Kjo pasuri është përfituar me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.04.2004, nënshkruar mes blerësve Xhemal dhe A. S. dhe shitësit shoqëria “{***}” ShPK, përfaqësuar nga F. H. dhe V. H. Në këtë kontratë parashikohet se, *me marrëveshje mes palëve, kjo pasuri i kalon palës blerëse, me çmimin prej 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë të reja, shumë kjo e likuiduar plotësisht.*

5.3. Si burim për krijimin e kësaj pasurie është deklaruar kredia e financuar nga ProCredit Bank, nëpërmjet kontratës së huasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.05.2004, nënshkruar midis huadhënësit ProCredit Bank ShA dhe huamarrëses A. S. e debitorit solidar Xhemal Saliaj, me objekt dhënie huaje në vlerën 35.000 euro, me destinacion *për banim*, me afat shlyerjeje brenda një periudhe 120-mujore, duke vendosur në hipotekë pasurinë objekt shqyrtimi dhe lënë peng (garanci objektesh) në vlerën 250.000 lekësh.

5.4. Në datën 17.05.2004, është disbursuar kredia në shumën 34.300 euro, në llogarinë e bashkëshortes së subjektit, e po në këtë datë, kjo shumë ka kaluar nga kjo llogari në llogarinë e shtetas V. H. me përshkrimin: “*A. D. tek V. H., kalim në llogari*”. Kjo shumë përfaqëson vlerën 4.384.569 lekë (34.300 euro), pra më e madhe se çmimi i apartamentit prej 3.500.000 lekësh, i përcaktuar në kontratën e shitjes, në një diferencë prej 884.569 lekësh më shumë, të cilën subjekti e ka pretenduar si shpenzim mobilimi.

5.5. Në deklaratat e interesave privatë të viteve 2004 – 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e kësteve të kësaj kredie, si dhe detyrimin e mbetur në fund të vitit, ndërsa në deklaratën e interesave privatë të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka shlyer totalisht kredinë e mbetur në vlerën 24.300 euro. Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar se, *me kontratë huaje, datë 25.06.2009, ka marrë hua nga J. S. (K.), shumën 17.000 euro, për tri vite, me interes zero (0). Në kontratën e thjeshtë të huasë, datë 25.06.2009, lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe motrës së tij, përcaktohet se kjo e fundit i ka dhënë hua vëllait të saj shumën prej 17.000 eurosh, me kushte kthimi për tri vite, me tri këste të barabarta, duke filluar nga data 25.06.2010.*

5.6. Gjatë hetimit administrativ në Komision ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, deri në datën 14.07.2009, kanë pasur detyrim ndaj bankës shumë 21.631 euro, të cilën e kanë shlyer para kohe, po në këtë datë, nëpërmjet depozitimit *cash* të shumës 22.005 euro, me përshkrimin “*derdhje për mbyllje kredie*”.

5.7. Në zbatim të detyrimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2026, në kuadër të verifikimit të mundësisë financiare të motrës dhe të familjes së saj për të dhënë huan në shumë 17.000 euro, rezultatet e analizës financiare në Kolegj treguan se personi tjetër i lidhur, në këtë rast motra, kishte mundësi që gjatë periudhës së analizuar të kursente shumë 11.461 euro dhe jo 17.000 euro, sa pretenduar dhe deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

5.8. Nga rishikimi i analizës financiare të Komisionit, lidhur me mundësinë e subjektit për shlyerjen e kredisë bankare, në datën 14.07.2009, shumica e trupi gjykues në Kolegj ka përlllogaritur në zërin “Të ardhura nga huaja e motrës” shumë prej 11.461 euro (konvertuar në 1.479.157 lekë). Rezultatet e kësaj analize treguan se subjekti i rivlerësimit rezulton me një balancë negative në shumë (-) 1.290.716 lekë, që në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, shumica e trupit gjykues e vlerësoi në atë nivel sa nuk e bën të zbatueshëm nenin 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, për deklarim të pamjaftueshëm.

6. Përpara se të ndalem në arsyetimin që përbën dhe thelbin e mendimit tim kundër vendimit të shumicës, nuk mund të lë pa përmendur faktin e mospërputhshmërisë së theksuar të të dhënave të ekstraktuara nga aktet në dosje gjyqësore, lidhur me çmimin e kësaj pasurie dhe shlyerjen e tij, që në vlerësimin tim, afektojnë vërtetësinë e akteve të nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, si dhe vërtetësinë e deklarimeve/shpjegimeve të dhëna në kuadër të këtij procesi. Më konkretisht: (i) Lidhur me vlerën e pasurisë, në kontratën e shitjes, palët kanë rënë dakord për çmimin 3.500.000 lekë, nga veprimet bankare ka rezultuar se është transferuar shuma 4.384.569 lekë, pra rreth 884.569 lekë më shumë se çmimi i parashikuar në kontratë, ndërsa në dokumentet financiare, pjesë e praktikës së kredisë, si formulari “*Financial project including DONE Investments*”, banka ka përlllogaritur një investim total prej 50.000 eurosh, e përbërë prej shumës 35.000 eurosh hua, 10.000 euro parapagim, dhe 5.000 euro riparime të ndryshme nga fonde të veta. Ndërsa në formularin F-1H, titulluar “Kërkesë kredie për shtëpi”, dorëzuar bankës nga vetë bashkëshortja e subjektit, ajo ka deklaruar dhe firmosur, në datën 08.04.2004, se vlera e investimit të tyre kishte kosto totale 6.000.000 lekë. (ii) Lidhur me shlyerjen e shumës, në kontratën e shitjes, të datës 29.04.2004, thuhet se çmimi prej 3.500.000 lekësh është likuiduar plotësisht, ndërsa kredia e financuar nga ProCredit Bank ShA, që ka shërbyer si burim likuidimi i kësaj shumë, rezulton të jetë disbursuar më datë 17.5.2004, pra 18 ditë më vonë nga kontrata e shitjes. Këto mospërputhje në vlerësim tim përforcojnë konkluzionin më poshtë lidhur me deklarin e pamjaftueshëm të pasurisë, i cili në të gjitha rastet ka qenë më i favorshmi për subjektin e rivlerësimit, duke pranuar pretendimet e tij se vlera e apartamentit ka qenë 3.500.000 lekë, dhe për pagesën e saj ka shërbyer kredia e financuar nga ProCredit Bank ShA.
7. Për t’iu rikthyer konkluzionit të shumicës së trupit gjykues, vlerësoj se ai vjen në kundërshtim me qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në jurisprudencën e tij dhe nuk është produkt i një vlerësimi të drejtë dhe objektiv. Në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur, në këtë marrëdhënie huaje të deklaruar dhe të

konfirmuar, mbartin detyrimin të provojnë ligjshmërinë e shumës së dhënë hua, në këtë rast 17.000 euro. E gjej të pabazuar në ligj arsyetimin e përdorur nga shumica e trupit gjykues, se duke qenë se motra kishte mundësi të kursente vetëm shumën 11.461 euro, nga 17.000 euro, që pretendohet t'ia ketë dhënë vëllait, për shlyerje të parakohshme të kredisë, në analizën financiare të përfshihet, nën zërin “Të ardhura nga huaja e motrës”, shuma 11.461 euro. Në vlerësimin tim, mungesa e mundësisë financiare të motrës për të krijuar shumën 17.000 euro, afekton ligjshmërinë e plotë të kësaj huaje dhe, për pasojë, huaja e deklaruar dhe e konfirmuar nga subjekti dhe personi tjetër i lidhur nuk mund të konsiderohet si e ardhur që ka shërbyer për shlyerjen e plotë të kredisë, më datë 14.07.2009. Nga ana tjetër, nuk e gjej bindëse marrjen e huas nga motra, pra të të gjitha kursimeve të saj dhe të bashkëshortit nga puna e tyre si emigrantë në Greqi, për të shlyer para kohe kredinë, në kushtet e mungesës së ngutshmërisë për të ndërmarrë këtë veprim financiar. Për këto arsye, vlerësoj të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të kryer pagesën e shumës 22.005 euro, shlyerje e parakohshme e kredisë në datën 14.07.2009, duke rezultuar me një balancë negative, në shumën (-) 2.769.873 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Kjo mungesë financiare e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për deklaram të pamjaftueshëm të kontrollit të pasurisë.

8. Në përfundim të arsyetimit më sipër, vlerësoj se vendimi nr. 805, datë 07.10.2024, i Komisionit, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, ishte i drejtë dhe i mbështetur në ligj dhe në prova, dhe duhet të lihej në fuqi, në bazë të nenit 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi